

KKRT – 2004

Pasqyra e lëndës:

1. Raport vjetor në Kuvendin e Shqipërisë
 - Hyrje, faqe 1
 - Pavarësia dhe aftësia vepruese e KKRT, faqe 2;
 - Administrimi i Frekuencave, faqe 4;
 - Programet radiotelevizive – dukuri dhe probleme, faqe 5;
 - Plotësimi i kushteve të licences nga operatorët kombëtarë, faqe 12;
 - Teknika numerike në transmetimet radiotelevizive në Shqipëri, faqe 13;
 - Precedenti “Digitalb”, faqe 19;
 - Televizioni publik dhe numerizimi i rrjeteve te transmetimeve televizive tokësore, faqe 23;
 - Bashkëpunimi me Kuvendin, Qeverinë dhe organet e tjera, faqe 25;
 - Detyrime ne raport me organizma ndërkombëtare të fushës, faqe 26;
2. Plani i Veprimit 2004, faqe 1 - 25
3. Mbulimi me sinjal i realizuar nga operatorët radiotelevizivë deri në fund të vitit 2004
4. Monitorimi i programeve informative (Aneks)
5. Realizimi i buxhetit për vitin 2004, detyrimet financiare të operatorëve radiotelevizivë (Aneksi 1, Tabela nr. 1 dhe Tabela nr. 1.1)
6. Të dhëna për veprimtarinë licensuese dhe ndëshkuese me operatorët radiotelevizivë (Aneksi 2, Pasqyrat e çështjeve gjyqësore dhe gjabave)

KESHILLI KOMBETAR I RADIOS DHE TELEVIZIONIT - KKRT

RREGULLIMË ME TERESORE DHE TE HARMONIZUARA PER TRANSMETIMET RADIO E TELEVIZIVE

*Raport për veprimtarinë e KKRT gjatë vitit 2004, paraqitur
në Kuvendin e Shqipërisë*

Hyrje

Edhe në Shqipëri ka kohë që është provuar se mediat e lira, të pavarura dhe profesionale, përbëjnë një komponente shumë të rendësishme në tërësinë e zhvillimeve që përjeton vendi dhe shoqëria. Me gjithë problemet që mbartin, mbetet i njëmendtë roli i tyre zhvillues, emancipues dhe qytetëruar në raportet që ato vodosin me njeriun dhe shoqërinë, me kulturën e vendit, me të shkuarën dhe të sotmen, me strukturat e shtetit ose çdo institucion tjeter. Për veçanësitë e njohura, me qëllim që media elektronike të përbushë gjithnjë e më mirë misionet e veta përballë publikut, është tashmë gjithashtu i provuar edhe roli rregulator i një institucioni, siç është Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit, që jo vetëm ndjek, pra monitoron përputhshmérinë me ligjin të veprimtarisë së secilit prej transmetuesve, por dhe bëhet garant i tyre për trajtim të barabartë në treg.

Duke e njohur dhe veçuar këtë rol, KKRT mbetet gjithnjë e përkujdesur për përmirësimë e, mundësish, sa vjen e më tepër përsosje të tij. Në këtë kontekst vijnë në ndihmë e janë bërë masa detyruar edhe përcaktimet nominale nga Vendimi i Këshillit të Bashkimit Evropian "Mbi parimet, përparësitë dhe kushtet e pënnbajtura në partneritetin Evropian me Shqipërinë", qershori 2004¹, masa të cilat tashmë janë programuar dhe është duke u bashkëpunuar edhe me institucione të tjera për zbatim.

¹ 1. Përparësitë afatshkurtra

...të përmirësohet legjislationi ekzistues mbi mediat elektronike, duke marrë në konsideratë standarde evropiane. Të merren masa për të siguruar transparencën përsa i përket pronësisë së mediave. Të sigurohet pavarësia e entit rregulator të medias, më qartë, e Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit. Të finalizohet Plani Kombëtar për Frekuencat e Radios dhe Televizionit..."

2. Përparësitë afatmesme

Të zbatohet legjislationi i ri për median elektronike dhe të shkruar, duke marrë në konsideratë standarde evropiane. Të sigurohet që caktimi i frekuencave televizive të kryhet në mënyrë të ndershme dhe jo diskriminuese, në përputhje me Planin Kombëtar dhe që kërkesat të respektohen plotësisht nga operatorët televizivë. Të përfundojë tranzicioni i RTSH nga një televizioni shtetëror në një transmetues neutral të shërbimit publik.

Në zbatim të misionit të tij, gjatë vitit 2004, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizonit, ka vazhduar përpjekjet për konsolidimin e institucionit, me synim arritjen e një rregullimi mediatik efektiv e të qëndrueshëm. Njëkohësisht, janë ndërmarrë hapa konkretë drejt konturimit të një strategje kombëtare për zhvillimin e sektorit të transmetimeve radio e televizive, përfshirë futjen e shërbimeve numerike. Njëherësh edhe përpjekjet në rritje kundër piraterisë për respektimin e të drejtës së transmetimit kanë sjellë rrjedhojat e veta, çka është reflektuar në disiplinimin e programeve radio e televizive bazuar në rregullat korrekte të konkurrencës, që është baza e një zhvillimi të balancuar të sektorit.

1. PAVARESIA DHE AFTESIA VEPRUESE E KKRT

Duke qenë se veprimtaria radio e televizive është fushë e ndjeshme e shoqërisë, si e tillë ajo kërkon liri dhe mbrojtje, rregullim dhe mbikqyrje të përshtatshme. Legislacioni përkatës dhe prezenca e institucionit rregulator, me përgjegjësitë e veta, kanë krijuar mundësitet që fusha në fjalë të zhvillohet përgjithësisht në normalitet. KKRT, nga ana e vet, është përpjekur të plotësojë misionin që i ngarkon ligji duke rritur pavarësinë dhe ruajtur transparencën. Eshtë rasti të sjellim në vëmendje edhe rekomandime si këto të mëposhtmet të Këshillit të Europës (2000) 23 të Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare kur flitet për pavarësinë dhe funksionet e autoriteteve rregulatorë për sektorin e transmetimit dhe për garancitë ligjore të pavarësisë nga autoritetet publike, forcat politike dhe interesat ekonomike.

Këto kërkesa përqëndrohen në:

1. statusi, emërimi dhe përbërja e autoriteteve rregulatorë,
2. pavarësia financiare dhe përshtatshmëria e burimeve,
3. fuqitë dhe kompetencat, si dhe
4. përgjegjshmëria kundrejt publikut.

Nëse, nga kuadri ligjor do të mungojë një nga këto kolona, Autoriteti Radioteleviziv nuk mund të jetë një organ rregulator vërtet i pavarur².

Nga këmbimi i përvojave brenda rajonit, por dhe më gjerë, është vërejtur se ligji shqiptar për median elektronike sjell një kuadër të përshtatshëm për transmetimet radio e televizive, madje sillet si shembull i mire. Megjithatë të gjithë po e vërejmë gjithashtu se

² Seminari për politikën Audiovizuale Europiane në Ballkanin Perëndimor me teme “ Autoritetet rregulatorë në qendrën e një rregullimi mediatik efektiv dhe të qëndrueshëm”, Shkup, 29-30 Nëntor 2004.

një kuadër i mire ligjor nuk është gjithçka. Praktika zbatuese sjell problemet e veta, të cilat na duhet t'i identifikojmë sa here që shfaqen. Në funksion të këtij raportimi në Kuvend, na duhet të veçojmë se autoriteti i rregulatorit jo në kuptimin ligjor, por në ecurinë zbatuese të ushtrimit të përgjegjësive shoqërohet me vështirësi, për zgjidhjen e të cilave jo gjithnjë është e mundshme të veprosh thjesht duke vënë përparrë paragrafet e ligjeve. Asnjëherë KKRT nuk ka abuzuar me të drejtat e veta, ndonëse mund e sigurisht ka vend të qortohet për mosveprime në raste të caktuara. Por nuk është vështirë të vihet re se në shumicën e rasteve, sidomos në rastet e disa operatorëve me më shumë "peshë", kur preken interesa, nuk ngurojnë të përdorin megafonet e tyre në dëm të autoritetit rregullues, duke keqpërdorur mundësitë që ata kanë, mundësi që nuk i kanë kolegët e bisneseve të tjera. Sidoqoftë kjo është një çështje etike që, me sa duket, do të kërkojë edhe kjo kohën e vet të maturimit. Vetë fakti që pothuaj të gjitha apelimet e bëra me rrugë gjyqësore ndaj vendimeve të KKRT-së nuk janë pranuar, duke i dhënë të drejtë asaj, jo e zakonshme krahasuar me institucionet e tjera; edhe kjo është shenjë përgjegjësie, maturie dhe serioziteti i këtij institucioni. E rendësishme është se po ndjehen frytet e një përvoje të mbrritur dhe më shumë po kuptohet se stabilizimi i autoritetit është bëri parësore, sepse po shihet se kjo gjë, në fund të fundit, është në dobi të gjithë operatorëve së bashku e pse jo edhe të secilit veçmas.

Plotësimi në korrik të vitit të kaluar i vendeve bosh me propozimet e opozitës, kjo pa dyshim e rrit më tej besueshmërinë e Këshillit dhe është në dobi të pavarësisë së tij. Gjithsesi, edhe disa masa të tjera janë menduar si të nevojshme të ndërmerrën. Një Kod Sjelljeje për anëtarët e Këshillit është duke u formatuar me thekse për pavarësinë dhe jonjëanshmërinë e kësaj trupe, si dhe të administratës së saj. Eshtë koha kur kode të tilla etike t'u kërkohen edhe operatorëve radiotelevizivë, cka është në dobi të profesionalizmit të tyre, ndihmon në marrëdhëniet me publikun dhe as cënon pavarësinë e tyre. Në perspektivë shkëputja e financimit nga buxheti i shtetit është edhe kjo në dobi të pavarësisë dhe të shmangies së ndikimeve nga qeveria, qofshin këto edhe në potencë. Sigurisht, kjo nuk është njëlloj me atë që ndodhi me buxhetin e sivjetëm, kur në mënyrë mekanike KKRT thuajse u shkëput nga financimet e shtetit, ndërkohë kur këtij institucioni nuk i janë siguruar ende mjediset e punës, cka për qeverinë është detyrim ligjor. Pa folur që do të duhet të mobilizohen fonde të tjera, sidomos në infrastrukturën teknike, por edhe fonde pagash, kur me ligj janë vënë detyrime shtesë, sic është e drejta e transmetimit, pa u menduar fare per strukturen perkatese. Sidoqoftë, KKRT, si autoritet rregulator, nuk është një ishull i izoluar, pasi efektiviteti i tij varet edhe nga faktorë të tjera. Bashkëpunimi me organet e agjencitë e tjera, qeveritare ose jo, si dhe mbështetja nga strukturat e shtetit, qendrore e lokale, organet fiskale etj., më kryesoret të parashikuara me ligj, janë vecanërisht të rëndësishme. Mbi të gjitha është bashkëpunimi me vetë operatorët, të cilët edhe pse shpesh pa dashje vihen në opozicion me rregulatorin, ata nuk do të jenë të suksesshëm pa mbështetjen e mirëkuptimin e njëri tjetrit.

2. ADMINISTRIMI I FREKUENCAVE

Fusha e administrimit të frekuencave, sado teknike, për nga pesha që mbart dhe problemet që ndeshen, është kthyer në çështje të rendit të parë në rolin që ka ky institucion dhe rregullimin e fushës në mënyrë korrekte, pa privilegjuar dhe pa diskriminuar askënd. Në këtë kuadër janë shfaqur probleme që duhet t'i njohim, institucioni raportues merr mbi vete përgjegjësitë por dhe përballjen me to. Sigurisht mbështetja e strukturave të Kuvendit jo vetëm do të ishte e kërkuar, por ashtu si deri më tanë, e pazëvendësueshme.

2.1. Implementimi i Planit të Rregullimit

Për përmirësimin e gjendjes, si dhe për të rritur kapacitetin e spektrit të shfrytëzuar, Departamenti Teknik ka punuar për sjelljen në normë të përdorimit të frekuencave në të gjitha pikat kryesore të transmetimit të identikuara. Kjo punë u konkretizua në hartimin e Planit të Rregullimit të Frekuencave.

Plani i Rregullimit u konceptua si plani më i thjeshtë e më i realizueshëm për disiplinimin e përdorimit të spektrit, sidomos në zonat e mbingarkuara. Ai parashikonte vetëm migrimin e transmetuesve në një frekuencë tjeter, pa ndryshuar parametrat e tjerë të tij, si fuqinë e daljes së transmetuesit, drejtimin e antenave, etj. Ky plan parashikon edhe rregullimin e përdorimit të të gjitha frekuencave të zëna, duke përfshirë aty ku është e mundur edhe ato të okupuara arbitrarisht nga operatorët që transmetojnë jashtë zonës së tyre të licencimit.

Bashkëpunimi i operatorëve për zbatimin e planit të rregullimit u evidentua qysh në fillim nga KKRT, si kushti themelor në realizimin e ndryshimeve rrënjosore në cilësinë e transmetimeve. Gjatë vitit 2004 janë bërë shumë përpjekje në të gjitha mënyrat për të siguruar këtë bashkëpunim të domosdoshëm. Për fat të keq, operatorët nuk iu përgjigjën ftesave të përsëritura të KKRT-së. Thoksojmë se viti 2004 nuk ofroi shumë mundësi për KKRT-në për të realizuar këtë detyrë:

1. Në muajin Qershor përfundoi mandati i 3 anëtarëve të KKRT-së. Duke marrë në konsideratë edhe vendin vakant qysh nga krijimi i KKRT-së, si dhe dorëheqjen e kryetarit, mund të themi së KKRT për një kohë mbeti pa mundësi vendimmarrjeje.
2. Në vitin 2004, edhe duke përfituar nga mungesa e vendimmarrjes së KKRT-së, vazhdoi fenomeni i daljes në transmetim pa autorizim, gjë që reduktoi numrin e frekuencave të disponueshme për të realizuar transferimin (migrimin).
3. Në rajonin më të rënduar (Tirana), Digitalb-i filloi transmetimet duke okupuar arbitrarisht 4 kanale UHF (62, 64, 67, 69), që zunë vendet e planifikuara për migrimin e transmetuesve të tjerë të licencuar rregullisht. Më keq akoma, ky operator po e zgjeron rrjetin duke instaluar impiante

4. Dalja pa autorizim e Digitalb-it dhe SAT+ zgjoi kundërshtimin e mjaft prej operatorëve dhe uli gatishmërinë e tyre për të zbatuar planin e migrimit.

Për mjaft operatorë ky është vit i rilicensimit të tyre. Eshtë duke u shfrytëzuar ky moment për të bërë disa rregullime të pjesshme nëpërmjet llicensave, pa iu larguar përkujdesjes për të arritur në një mirëkuptim të ndërprerë me operatorët në këtë sipërmartje të përbashkët.

2.2. Mbyllja e stacioneve që mbulonin të njëjtin territor me të njëjtin program

Me perfundimin e afatit të veprimit të ligjit nr. 8969, datë 07.11.2002, "Për disa masa në fushën e transmetimeve radiotelevizive", KKRT ndërmori masa për mbylljen e stacioneve të identikuara që dublonin mbulimin e territorit, në përputhje edhe me rekomandimet e OSBE-së. Kjo krijoji një sasi të vogël kanalesh të lira.

Ndërkaq, gjatë vitit 2004 janë identifikuar operatorë (TV Top Channel, TV Amantia, etj) që kanë instaluar transmetues për të dubluar mbulimin e territorit duke reduktuar numrin e frekuencave të lira. Pavarësisht se transmetues të tillë nuk janë të legalizuar nga KKRT, ata krijojnë konfuzion në administrimin e frekuencave dhe janë burim interferencash. Në këto raste, KKRT ka reaguar duke akorduar gjoba dhe urdhëruar mbylljen e menjëherëshme të transmetimeve të paautorizuara.

2.3. Për transmetimet e palicencuara

Siq e tregoi Harta e Frekuencave, një numër operatorësh, sidomos ata që kanë licencë për të operuar mbi 4 prefektura, kanë okupuar frekuencia jashtë zonës së tyre të licencimit. Deri më sot, ata vazhdojnë të mos paguajnë detyrime për mbulimet jashtë zonës së licencimit, duke konkuruar në mënyrë të pandershme me operatorët e licencuar sipas ligjit. Eshtë përgjegjësi e tyre dhe e organit rregulator për mosndërhyrje në kohën kur ka ndodhur ky abuzim. Por më tej është pranuar si më i arsyeshëm rregullimi me aktet përkatëse i kësaj gjendjeje. Një rrugëzgjidhje është parashikuar licensimi i përkohshëm, çka është nën vizuar edhe në raportin për vitin 2003 paraqitur Kuvendit. Edhe pse mënyra e zgjidhjes mund të rishikohet, ajo që mbetet për t'u bërë është imperativi i rregullimit. KKRT mbetet veçanërisht e interesuar e njëherësh e gatshme të plotësojë gjithçka do t'i kërkohet në marrëdhëniet e saj me Kuvendin.

3. PROGRAMET RTV - DUKURI DHE PROBLEME

Edhe gjatë vitit 2004 ajo çka është ndjekur është zbatimi i parimeve themelore të veprimtarisë radiotelevizive, që kanë të bëjnë me të drejtën për informim, në respektimin e bindjeve politike, jetës private të njeriut, si dhe të drejtat themelore të tij. Qëllimi ishte të përbusheshin kushtet për paanshmërinë, plotësinë dhe pluralizmin e informacionit, si

dhe të garantohej konkurenca e ndershme në fushën e transmetimit të programeve. Rrugët e ndjekjes kanë qenë:

- Monitorimi i programeve informative të transmetuesve rtv kombëtarë
- Respektimi i të drejtave të transmetimit nëpërmjet zbatimit të ligjit Nr. 9124, datë 29.07.2003

3.1 Monitorimi i programeve informative

Ligji “Pë radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”, përcakton si detyrim ligjor monitorimin e programeve informative të operatorëve radiotelevizivë kombëtarë. Departament përkatës e ka bërë praktikë që përfundimet e monitorimit t'u bëjë të njohura për çdo muaj të gjitha subjekteve mediatike mbi të cilat është aplikuar monitorimi, si dhe institucioneve të tjera të interesuara. Fjala është për të dhëna statistikore për kohën që zënë në edicionet e lajmeve veprimtaritë e forcave politike, të institucioneve shtetërore, po kështu edhe të dhëna për vendin që kanë zënë në këto edacione tema të tilla si politika, lajmet ndërkombëtare, ekonomia, veprimtaritë e Parlamentit, të qeverisë, arsimi, arti dhe kultura, kronika e zezë, shëndetësia, kriminaliteti, biznesi, sporti etj.

Na duket se është me interes një vëzhgim i përmuajshëm se si ravijëzohen qëndrime të ndryshme për të njëjtin lajm. Këto tendencia favorizuese ose të njëanshme për forca të caktuara politike u janë vënë në dukje operatorëve me qëllim reflektimi për informacion korrekt dhe të ekuilibruar.

Në **Radiotelevizionin Shqiptar**, temat kryesore të trajtuar gjatë edicionit të lajmeve kanë qenë “problemet sociale” dhe “lajmet ndërkombëtare”, respektivisht me 16% dhe 14% të kohës së lajmeve, ndryshe nga një vit më parë, ku vendin kryesor e zinte tema “politika” me rreth 20%. Gjatë vitit 2004, koha për pasqyrimin e veprimtarive politike të partive joqeverisëse (rreth 18.2 %), ka qenë gjithmonë më e madhe se koha në dispozicion të partive të koalicionit qeverisës (rreth 13.7 %). Për institucionet, kohën më të madhe në dispozicion në edicionet kryesore të lajmeve gjatë vitit 2004 e ka patur Qeveria me 29.4 % dhe Kryeministri me rreth 21.7 %. Veçojmë që institucionet shtetërore në RTSH, kanë pasur gjithmonë në dispozicion dyfishin e kohës së pasqyrimit të veprimtarive të partive politike të marra së bashku. Aktori kryesor në sinkron ka qene z. Fatos Nano

Në **Televizionin “KLAN”**, tema kryesore e trajtuar gjatë edicionit të lajmeve ka qenë “politika”, me rreth 20 për qind të kohës së lajmeve, ndryshe nga një vit më parë ku vendin qëndror e zinin “lajme nga bota”. Edhe në këtë televizion koha për pasqyrimin e veprimtarive politike të partive joqeverisëse (28.5 %), ka qenë gjithmonë më e madhe se ajo në dispozicion të partive të koalicionit qeverisës (rreth 23.8 %). Për institucionet, kohën më të madhe në dispozicion e ka patur Qeveria (rreth 18.1 %) dhe Kryeministri (rreth 8.5 %). Aktori kryesor sinkron në TV Klan ka qenë z. Sali Berisha.

Ne **Televizionin “Arberia”** temat kryesore të trajtuarë gjatë edicionit të lajmeve kanë qenë “lajmet ndërkombëtare” dhe “problemet sociale”. Koha për pasqyrimin e veprimtarive politike të partive joqeverisëse (23.83 %) në edicionet kryesore informative në TVA, ka qenë më e madhe se koha në dispozicion të partive të koalicionit qeverisës (rreth 19 %). Për institucionet, kohën më të madhe në dispozicion e ka patur Qeveria (rreth 25.3%) dhe Kryeministri (rreth 17.5 %).

Në **Top Albania Radio**, temat kryesore të trajtuarë gjatë edicionit të lajmeve kanë qenë “problemet sociale”, “lajme ndërkombëtare” dhe “politika”. Koha për pasqyrimin e veprimtarive politike të partive joqeverisëse, ka qenë gjithmonë më e madhe se koha në dispozicion të partive të koalicionit qeverisës në TAR. Për institucionet, kohën më të madhe në dispozicion e ka patur Qeveria dhe Parlamenti. Në Top Albania Radio, veprimtaritë e partive politike kanë patur gjithmonë në dispozicion, dyfishin e kohës së pasqyrimit të veprimtarive të institucioneve shtetërore.

Edicionet e lajmeve mbeten programet më të konsoliduara në strukturën programore, jo vetëm të operatorëve kombëtarë, por edhe të operatorëve vendorë, tashmë tepër konkurrues në median elektronike, si Top Channel, “Vizon +”, TV “Koha”, etj. Vlen të përmendet edhe roli mjaft i ndjeshëm i transmetuesve të tjerë vendorë në fushen e informimit, si p.sh. televizionet: “Adriatik TV”, “Teuta”, TV “Puka”, TV “6+1”, “Kombi”, TV “Apollon”, “ARV”, “Puka”, “Kristal”, “Kruja”, “4+” në Lushnje, TV “Rozafa”, TV “Bajram Curri” në Tropojë, TV “Klaudiana” në Peqin, apo radiot: “Alpo” në Gjirokastër, Radio “Saranda” në Sarandë, “ABC” në Korçë, “Valë e Kaltër” në Vlorë, “Radio e Parë” në Mat, Radio “Fieri”, Radio “Prespa”, etj.

Megjithë vështirësitë, media elektronike shqiptare po perfektionohet nga dita në ditë. Ajo gjithmonë e më shumë është pranë njerëzve, pranë problemeve të tyre, pranë pasqyrimit të së vërtetës. Media elektronike gjithmonë e më tepër po e rrit trysninë ndaj strukturave shtetërore, por edhe mbi politikën për të luftuar korruptionin dhe krimin në dobi të mirëfunkcionimit të saj.

Më poshtë, po paraqesim tabelat me të dhënat e monitorimit të programeve informative të operatorëve kombëtare për vitin 2004.

Tabela mbi kohen e plotë dhene subjekteve politike ne edicionin kryesor te lajmeve
(Koha ne %)

	Subjekti (Koha e Plotë)	TVSH	KLAN	TVA	Shuma
Institucionë	Presidenti	7.32%	2.62%	4.72%	5.07%
	Kryeministri	21.66%	8.45%	17.55%	16.26%
	Qeveria	29.42%	18.14%	25.25%	24.62%
	Parlamenti	9.59%	12.03%	8.34%	10.01%
Partite Politike	Partia Socialiste	10.78%	15.31%	14.53%	13.31%
	Lëvizja Socialiste për Integrim	0.09%	5.82%	1.07%	2.20%
	Partia Socialdemokrate	1.02%	2.94%	1.48%	1.76%
	Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut	0.37%	2.12%	0.87%	1.07%
	Partia Aleanca Demokratike	0.26%	1.43%	0.90%	0.82%
	Partia Agrare Ambientaliste	0.27%	0.81%	0.57%	0.53%
	Partia Demokracia Sociale	0.97%	1.21%	0.65%	0.95%
	Partia Demokratike	13.22%	22.00%	16.65%	17.01%
	Partia Republikane	2.00%	2.89%	2.55%	2.44%
	Partia Lëvizja e Legalitetit	0.44%	0.56%	1.01%	0.64%
	Lëvizja për Zhvillim Kombëtar	0.09%	0.60%	0.23%	0.29%
	Partia Balli Kombëtar	0.14%	0.22%	0.35%	0.23%
	Partia Bashkimi Liberal	0.20%	0.09%	0.28%	0.19%
	Partia Demokrate e Reformuar	1.40%	1.19%	2.24%	1.58%
	Partia Demokristiane	0.25%	1.07%	0.11%	0.47%
	Partia Demokratike e Rinovuar	0.11%	0.22%	0.38%	0.23%
	Parti të Tjera	0.41%	0.28%	0.25%	0.32%
Shuma sipas Operatorëve		100.00%	100.00%	100.00%	100.00%
Partite Qeverisese		13.66%	23.81%	19.00%	18.44%
Partite Opozitare		18.18%	28.53%	23.83%	23.11%

Tabela mbi kohen sinkron dhene subjekteve politike ne edicionin kryesor te lajmeve
 (Koha ne %)

Subjekti (Koha Sinkron)	TVSH	KLAN	TVA	Shuma
Presidenti	3.99%	2.00%	2.71%	2.87%
Kryeministri	16.52%	6.02%	13.15%	11.60%
Qeveria	31.13%	16.06%	24.90%	23.66%
Parlamenti	5.18%	8.50%	4.23%	6.14%
Partia Socialiste	14.92%	16.69%	17.77%	16.43%
Lëvizja Socialiste për Integrim	0.06%	6.43%	1.16%	2.76%
Partia Socialdemokrate	1.28%	3.84%	2.00%	2.45%
Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut	0.40%	2.59%	0.95%	1.38%
Partia Aleanca Demokratike	0.36%	1.69%	1.13%	1.08%
Partia Agrare Ambientaliste	0.31%	1.13%	0.66%	0.72%
Partia Demokracia Sociale	1.16%	1.52%	0.87%	1.21%
Partia Demokratike	17.99%	24.86%	21.46%	21.58%
Partia Republikane	3.05%	3.68%	3.24%	3.34%
Partia Lëvizja e Legalitetit	0.45%	0.72%	1.19%	0.77%
Lëvizja per Zhvillim Kombëtar	0.03%	0.62%	0.19%	0.30%
Partia Balli Kombëtar	0.16%	0.21%	0.43%	0.26%
Partia Bashkimi Liberal	0.35%	0.09%	0.30%	0.24%
Partia Demokrate e Reformuar	1.73%	1.19%	2.68%	1.81%
Partia Demokristiane	0.44%	1.49%	0.23%	0.77%
Partia Demokratike e Rinovuar	0.14%	0.33%	0.51%	0.32%
Parti të Tjera	0.36%	0.31%	0.24%	0.31%
Shuma sipas Operatorëve	100.00%	100.00%	100.00%	100.00%
Partite Qeverisese	18.44%	27.45%	23.38%	23.27%
Partite Opozitare	24.66%	32.90%	30.28%	29.40%

3.2 Mbi piraterinë në radiotelevizion

Përpjekjet e KKRT-së për të minimizuar fenomenin e piraterisë në transmetimet televizive u shumëfishuan pas miratimit të Ligjit Nr. 9124, datë 29.07.2003, “Për disa shtesa në Ligjin Nr. 8410, datë 30.09.1998, “Për radion dhe televizionin publik dhe privat në RSH”, i ndryshuar.

Masat e mëposhtme:

- Hartimi dhe miratimi i rregullores për depozitim e dokumentacionit përkatës për të drejtat e transmetimit
- Njoftimet në shtyp për piraterinë
- Intervistat në radiotelevizion dhe botime të ndryshme në organet e medias së shkruar
- Spotet radiotelevizive kundër piraterisë
- Bashkëpunimi me të gjitha subjektet radiotelevizive
- Organizimi i monitorimit është vazhdueshëm të programeve radiotelevizive në Studion e Montorimit dhe nëpër rrethe

krijuan një mjeshtëri favorshëm për të ndërhyrë me forcën e ligjit ndaj atyre operatorëve televizivë që vazhdonin të transmetonin programe pirate. Procesi ishte i vështirë, por shumë shpejt u arrit që të paktën operatorët televizivë me sinjal në Tiranë, me disa përjashtime, të respektuan ligjin. Sidomos në gjashtëmuajorin e parë të vitit 2004, pjesa më e madhe e operatorëve transmetuan programe të ligjshme. Disa raste përjashtimore u përballën me sanksione dhe gjendja u stabilizua. Bashkëpunimi me operatorët përgjithësisht ka qenë mirëkuptues dhe në tërësi procesi solli një hop në profesionalizëm.

Pas futjes në treg të shërbimeve radiotelevizive dixhitale tokësore dhe satelitore, të paparashikuara në ligj dhe të paautorizuar sipas ligjit, pati një lloj reagimi negativ nga disa operatorë deri atje sa të dalë në transmetim në kanalin 29, më 30.07.2004, edhe një operator i panjohur, kuqtohet i paligjshëm, me logon kundrapunt “Digital Pirat. Në të njëjtën kohë u bë e mprehtë mënyra si po funksiononin operatorët kabllorë, të cilët nuk është se po konkuronin ata tokësore, por po e bënin duke u marrë këtyre të fundit deri edhe mjaft programe të blera, pra me të drejta ekskluzive transmetimi. Eshte kjo arsyje qe atë kohë u bë një lloj zhurmë mediatike për rezikun e rikthimit të mundshëm në pirateri. KKRT e përcaktoi qartë dhe e shpalli publikisht se rikthimi në pirateri, sjell kaos, shkakton deformim të tregut e konkurencës së ndershme dhe shkatërrim të vetë medias elektronike. Nuk është se KKRT vetëm sa e tha këtë gjë, por ajo mori vendimet përkatëse dhe prej disa muajsh është duke kërkuar dhe kontrolluar dokumentacionin e nevojshëm që vërteton të drejtën e transmetimit të programeve, çka është shoqëruar edhe me sanksione në një pjesë të madhe të tyre. Vështirësitet e ndeshura dhe mbingarkesa e krijuar për institucionin monitorues, ndonëse është shembull i vetëm për një detyrim ligjor si ky, nuk do të thotë se përbëjnë kurrfarë arsyje shmangëse e aq më pak shfajesuese. Përkundrazi, pirateria, ndonëse një dukuri globale, po identifikohet, lokalizohet dhe ngushtohet, kësisoj është duke u përballuar gjithnjë e më mirë.

Ndoshta në kohën e daljes së ligjit për të drejtën e transmetimit ende operatorët radiotelevizivë në Shqipëri nuk qenë aq të përgatitur për të sjellë programe të vetat konkuruuese dhe atëherë u shfaq një lloj boshllëku. Po më tej pati zhvillime dukshëm përmbarë. Tash sa vjen e më shumë po vijnë programe të blera me cilësi në rritje dhe, më e rendësishmja kjo, po prodhohen programe që tentojnë cilësi artistike dhe përbajnjë vlera formuese dhe edukuese. Edhe pse me diferenca, është rasti të veçojmë disa prej këtyre programeve, si shembull inkurajues dhe si shtrat për zhvillime të tjera edhe më pretenduese:

- Maratona e spektaklit “Gjeniu i vogël”, “Kombinat Show”, “Kutia e fundit” e “Taksi e rezervuar”, si dhe evenimente të tjera kulturore dhe artistike në Televizionin “KLAN”, dukuri që ka çuar në shtimin e programeve të prodhuarat vetë në këtë televizion
- “Top Show”, “Portokalli”, “Top select”, “Jashtë bulevardit”, “Fix fare”, e programe të tjera me karakter argëtues e kulturor në Top Channel, duke e kthyer gjithnjë e më shumë në një nga televizionet më të ndjekur në vend
- “Zonë e lirë”, “Splash” e “Intervista” në Televizionin “Arbëria”
- “Ethet e të premtes & Krasta Show”, “Shënjestra”, “Kub”, “Ca gjëra nuk thuhen”, “Friends”, “Të padukshmit”, “Quiz +” në “Vizion +”, duke rifreskuar më tej ftyrën sociale të këtij televizioni në kërkim të një audience gjithmonë në rritje
- “Shtëpia jonë”, “Bla-bla”, “Koha jonë”, “Perspektivë”, “Bibliotekë”, e programe me temat më të ndjeshme kulturore, sociale dhe politike në Televizionin “Koha”
- “Jo vetëm kafe”, “Amazonat”, “Hapësire e blertë”, “Troq” në Televizionin Shqiptar dhe transmetimi i evenimenteve të mëdha kulturore dhe sportive si Festivali Folklorik e Gjirokastrës, Festivali i Këngës në RTV e Festivali European, Kampionati European i Futbollit, etj

Jo vetëm programe si këto që u përmendën, po edhe të tjera, siç janë një varg emisionesh opinione dhe analiza për çështje të ditës ka bërë që operatorët të konsolidojnë fisionominë e tyre e paralelisht me të, të zgjerojnë audiencën. Megjithatë, KKRT, duke qëmtuar rrugë të tjera bashkëpunimi do të kërkojë hapësira për të ndikuar që edhe programe të quajtura të sukseseshme, të mos kthehen në parada vulgariteti dhe ndonjëherë parodi të shëmtuara të dinjitetit kombëtar.

Departamenti i Programeve ka ushtruar kompetencat e veta edhe në drejtim të respektimit të kërkesave për reklamat në transmetimet e operatorëve radiotelevizivë. Fenomeni më i përfolur dhe praktikisht më i pazbatueshëm është ndërprerja e programeve me blloqe reklamash, duke mos respektuar afatet kohore të parashikuara në nenin 52 të ligjit. Në këtë nen përcaktohet se çdo ndërprerje me reklama nuk bëhet pa kaluar të paktën 20 minuta nga ndërprerja më e afërt. Ndërsa, për filmat artistikë, ndërprerja mund të bëhet për çdo periudhë prej 45 minutash me blloqe, që nuk i kalojnë 2 minuta. Për këtë shkelje janë paralajmëruar operatorë si “Klan”, “Top Channel”, “Koha”, TVA, “Vizion +”,

etj.Gjithashtu, janë paralajmëruar edhe ata operatorë që transmetojnë herëpashere reklama në gjuhë të huaj, si “News 24”, “Koha” respektivisht për reklamë orësh e reklama pijesh freskuese.

Gjatë vitit 2004 nuk janë aplikuar transmetimet e reklamave të duhanit e produkteve të tij në subjektet e licensuara. Bën përjashtim reklama indirekte e “Karelia Slim”, dhënë nga TVSH dhe “News 24”, gjatë transmetimit të përbashkët të “Kafazit të artë”, e për të cilin, KKRT mori masat përkatëse parandaluese në rast përsëritjeje.Gjatë vitit 2004 u reduktua në minimum përdorimi masiv i reklamave të shërbimit telefonik me vlerë të shtuar, gjatë transmetimit të programeve. Bën përjashtim vetëm “Telenorba Shqiptare”, që e ka aplikuar këtë metodë gjatë transmetimit të ekranizimeve e emisioneve të ndryshme, duke zbehur vlerat artistike të programeve që transmeton. KKRT ka qenë në komunikim edhe me këtë operator për rregullimin ligjor të këtij funksionimi.

E përgjithshmja është që operatorët radiotelevizivë janë tepër të interesuar të zbatojnë kërkesat e ligjit në fushën programore, gjë që do të pasqyrohet edhe në rritjen e nivelit profesional të këtyre transmetuesve.

4. PLOTESIMI I KUSHTEVE TE LICENCES NGA OPERATORET KOMBETARE

Edhe gjatë vitit 2004, KKRT e ka ndjekur ecurinë e operatorëve radio e televizivë kombëtarë për zbatimit të planit të mbulimit të territorit të Shqipërisë me sinjal, si dhe plotësimin e kushteve të tjera të licencës.Fillimisht, përgatitja e planit të frekuencave për këta operatorë u bazua në gjendjen e gjetur, duke kërkuar edhe çdo mundësi për të bërë përshtatjen me një studim të realizuar kohë më parë nga RTSH. Me përpilimin e planit të rregullimit, është bërë e mundur që të identifikohen frekuanca më të përshtatshme për zgjerimin e rrjeteve të TV kombëtare.

Bazuar në ligjin “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë” (Neni 20):“*Mbajtësi i licencës për transmetim radioteleviziv kombëtar duhet të realizojë mbulimin e mbi 70 % të territorit të vendit. Brenda 6 vjetësh, ky mbulim duhet të arrije të përfshijë deri në 90 % të territorit dhe jo më pak se 90 % të popullsisë*”. Në planin e detajuar të zgjerimit për çdo vit, KKRT ka parashikuar një zhvillim gradual e të balancuar të mbulimit në të gjithë territorin e vendit, duke u kujdesur që të favorizohen zonat e largëta e më pak të zhvilluara ekonomikisht, ku operatorët lokalë e kanë vështirë të mbijetojnë. Të dhënrat e mëposhtme janë edhe deyrinë të detajuara për çdo vit.

Nr.	Operatori	Zona e Licencimit	Mbulimi		
			Dhjetor 2002 Viti II	Dhjetor 2003 Viti III	Dhjetor 2004 Viti IV
	KKRT – Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit – Raport vjetor 2004				

			Kusht et e licenc.	Mbuli mi faktik	Kusht et e licenc.	Mbuli mi faktik	Kusht et e licenc.	Mbuli mi faktik
1.	TVSH	Kombëtar	-	73,31	-	73.31	-	73.31
2.	TV ARBERIA	Kombëtar	7,33	27,39	26,4	30,1	46,97	30,1
3.	TV KLAN	Kombëtar	7,33	40,91	26,4	42,68	46,97	42,68
4.	R. TIRANA	Kombëtar	-	80,54	-	80,54	-	80,54
5.	R. TOP ALBANIA	Kombëtar	28,85	87,22	55,76	87,22	72.69	87,22
6.	RADIO + 2	Kombëtar	-	-	55,76	72,64	72,69	72,64

Mbulimi i RTSH-së është dhënë i pandryshuar, pasi nuk janë identifikuar ndryshime të rrjetit bazë të transmetimit, përveç disa ndërhyrjeve me përsëritës me fuqi të vogël që kanë rritur cilësinë e mbulimit me sinjal.

Siq del na tabela e mësipërme, treguesit e mbulimit për vitin 2004, që janë edhe kushte të licensës, nuk u realizuan. Me mosrealizim të ndjeshëm eshtë TV ARBERIA, operator që po rrezikon të mos u përgjigjet detyrimeve që vetë ka zgjedhur. Edhe pse ky operator ka bërë një kërkesë për frekuencia në zgjerim të zonës së mbulimit, duhet thënë se pikat e transmetimit të zgjedhura nga TVA, nuk përputhen me pikat e përcaktuara në licencë, si dhe me planin e rregullimit, pa folur që në kushtet kur nuk janë kryer detyrimet për licencën dhe taksat për frekuencën, nuk ka as garanci që ky studim të realizohet.

5. TEKNIKA NUMERIKE NE TRANSMETIMET RADIOTELEVIZIVE NE SHQIPERI

5.1. Numerizimi i studiove te transmetimit

Në transmetimet radio e televizive, përpjekjet për aplikimin e teknikave numerike, si teknika që sigurojnë cilësi dhe efektivitet të lartë, kanë kohë që kanë filluar.

Përpjekjet kanë marrë hov, sidomos me krijimin e operatorëve privatë radio e televizivë, të cilët kanë një fleksibilitet më të lartë se operatori publik në përdorimin e fondeve për përmirësimin cilësor. Si rezultat, shumë operatorë radio e televizivë, kanë futur në masë teknikën numerike në studiot e prodhimit. Aktualisht, ka operatorë radio apo televizivë, që në studion e prodhimit përdorin 100 % teknologjinë numerike, duke filluar nga kamerat, deri në montazh, dhe në regjistrimin e ruajtjen e produktit audiovizual. Tashmë, studiot e prodhimit e transmetimit radio apo televizive dallohen me vështirësi nga studiot e qendrave informatike, etj, për nga numri i aparaturave numerike

dhe PC-ve që janë në përdorim për të realizuar produkte audiovizuale me cilësi të lartë. Sidoqoftë, ndryshe nga niveli i numerizimit i arritur nga sistemet e tjera të telekomunikacioneve, numërizimi i studiove televizive në shkallë vendi është akoma në nivele jo të larta.

5.2. Numerizimi i lidhjeve të studiove me pajisjet transmetuese

Pajisjet numerike për realizimin e lidhjeve pikë-më-pikë të studiove me pajisjet transmetuese (sistemet radio reale numerike) janë të pranishme gjërësisht në tregun shqiptar, pasi ato përdoren nga të gjitha sistemet e telekomunikacioneve (telefoni, fiksë e e lëvizshme, internet, etj). Por, aplikimi i tyre për transmetimet radio e televizive pengohet nga ekzistencë e transmetuesve të bazuar në teknikën analogjike. Transmetimi numerik deri tek transmetuesi dhe konvertimi në analog para transmetimit, rezulton cilësisht i papërshtatshëm dhe ekonomikisht i kushtueshëm. Për pasojë, duke mos marrë në konsideratë sistemet e ndërtuara nga Digitalb, ky segment i realizimit të transmetimeve radio e televizive, rezulton krejtësisht i bazuar në teknikën analogjike dhe i nënshtrohet të gjitha mungesave dhe të metave të transmetimeve analogjike (kapacitete të ulëta, efektivitet i ulët në përdorimin e brezit të frekuencave, ndjeshmëri të lartë ndaj interferencave të shkaktuara nga transmetues të tjerë, si dhe nga agjentët atmosferikë, etj)

5.3. Numerizimi i transmetimeve radio e televizive

5.3.1 Gjendja e transmetimeve radio e televizive në Shqipëri

Dihet se KKRT nuk ka trashëguar asnjë studim të plotë për mbulimin e territorit shqiptar me sinjale televizive apo dokument koordinimi të frekuencave televizive me fqinjët. Në këto kushte, detyrë kryesore nuk mund të ishte tjetër, përvçse masat për një përdorim të disiplinuar të frekuencave, të cilat janë pasuri kombëtare e kufizuar. Bazuar në Hartën e Frekuencave të Transmetimeve Televizive, KKRT hartoij një plan veprimi që përcakton zgjidhjen me afate të dhënies së frekuencave të mbrojtura për çdo operator, me anë të migrimit të tyre, apo edhe të mbylljes së impianteve jashtë parametrave dhe të paautorizuar. Një nga masat e menjëherësme që rekomandoi Harta e Frekuencave ishte pezullimi i licencave të reja për transmetime televizive në rajonin e Tiranës, të mbingarkuar me sinjale (27 transmetues të instaluar në malin e Dajtit³).

Duket sikur nën perspektiven e kalimit në transmetimet numerike, përpjekjet e KKRT-së për disiplinimin dhe sjelljen në normë të transmetimeve analoge, ngjan si punë e padobishme që nuk i shërben të ardhmes. Duke qenë se periudha e bashkëjetesës midis transmetimeve analogjike dhe atyre numerike tokësore nuk do të jetë aq e shkurtër, kjo do të thotë se masat disiplinuese për mbajtjen në normë të këtij sistemi nuk duhet të ulen,

³ KKRT, Raporti Vjetor 2003

pa folur se këto masa bëjnë të lirohen hapësira te reja spektrale për vetë transmetimet numerike.

5.3.2. Konsiderata të KKR-së mbi ndërtimin e rrjeteve për transmetime numerike televizive në Shqipëri

Në Raportin e vitit të shkuar që i është paraqitur Kuvendit thuhet: “*Eshtë fakt se nga operatorë dhe persona të veçantë ka filluar interesimi për futjen e kësaj teknologjie edhe në vendin tonë. Nga KKRT po merren masa për kanalizimin e këtij interesimi në favor të zhvillimit të harmonizuar, për të mos krijuar probleme më vonë. Për këtë qëllim, është vendosur që, krahas Planit të Frekuencave Analoge Tokësore që u përmend më sipër, të zhvillohet edhe Plani i Frekuencave Dixhitale Tokësore, duke shfrytëzuar të njëjtat pika transmetuese, mbështetur edhe në eksperiencën italiane, që patëm rastin ta studiojmë gjatë një vizitë pranë organit rregullator Italian AGCOM, të zhvilluar gjatë muajit Korrik 2003. Bazuar në punën përgatitore të zhvilluar dhe që do të zhvillohet gjatë vitit 2004, brenda këtij viti, KKRT mund të jetë në gjendje të autorizojë lejet e para eksperimentale televizive dixhitale tokësore.*”⁴

KKRT i përbahet mendimit se rregullimi i transmetimeve televizive tokësore në sistemin numerik do të përcaktohet pas organizimit të një numri konsultash dhe analizash me të gjithë aktorët e tregut audioviziv.

5.3.3. Faktorët në dobi të transmetimeve televizive dixhitale

- **Kërkosat në rritje për licencë**, sidomos për rajonin e Tiranës dhe Ultësirën Perëndimore, mund të plotësohen vetëm nëpërmjet futjes së teknologjise numerike.
- **Shumë vende kanë caktuar datën e mbylljes së shërbimit analog**. Kjo do të thotë se një ditë industria do të reduktojë dhe në fund do të ndërpresë prodhimin e pajisjeve që përdorin teknikën analoge. Shqipëria, si vend importues, është në varësi të teknologjisë që prodhohet në Evropë e më gjërë. Prandaj, në varësi të zhvillimeve rajonale, **duhet planifikuar futja e teknologjisë numerike**.
- Në përgjithësi, me përjashtim të 2-3 operatorëve, pajisjet transmetuese analoge të instaluara nga operatorët janë pajisje të përdorura e të konsumuara, të nxjerra jashtë përdorimit nga operatorë jashtë vendit, kryesisht italianë. Ndërtimi i **rrjeteve numerike nga operatorë rrjeti të specializuar**, duke e shndërruar shumicën e operatorëve aktualë në **Ofrues përbajtjeje (Content provider)**, jo vetëm do të përmirësojë cilësinë teknike të transmetimeve, por do të shkurtojë shpenzimet e tyre për ngritjen e mirëmbajtjen e rrjetit, duke i lejuar të fokusohen vetëm në prodhimin e programeve.

⁴ KKRT-Raport Vjetor 2003, fq. 22

- Aplikimi i teknologjisë numerike, duke lejuar futjen e shërbimeve të reja (akses i kushtëuar, VOD, NVOD, shërbime interaktive), do të krijojë **burime të reja financiare** për mbështetjen e industrisë së transmetimeve televizive, që sot mbështetet kryesisht në reklamat dhe sponsorizimet.
- Aplikimi i teknologjisë numerike do të lejojë përmirësimin rrënjesor të cilësisë së transmetimeve televizive.
- Aplikimi i teknologjisë numerike, në brezin IV dhe V UHF mund të realizohet lehtësish duke përdorur të njëtin sistem antenash që përdoret për marrjen e sinjaleve analoge.

5.3.4 Problemët që pritet të hasen

- Teknologja numerike kërkon investime të konsiderueshme për rrjetet e transmetimit. Nëse në sektorin privat investimet për këtë teknologji mbeten në dëshirën dhe riskun e vetë operatorëve, në sektorin publik, vendimi për të investuar fonde publike do të merret pasi të krijohet bindje e plotë për fizibilitetin e tij ekonomik e avantazhet që do të sjellë. Një vendim si ky është edhe përgjegjësi që duhet të përligjet me përmirësimin e bilancit ekonomik të operatorit publik, si dhe me ngritjen e nivelit cilësor të programeve dhe fuqizimin e shërbimeve për publikun e gjerë. Nga ana tjetër, ndërsa lënia e zhvillimit në vullnetin e investitorëve privatë, do të thotë një zhvillim spontan në varësi të shumë të panjohurave, planifikimi i zhvillimit nëpërmjet investimeve të qëndrueshme nga ana e operatorit publik, lejon dhe e kërkon një zhvillim të programuar.
- Një nga vështirësítë mendohet të jetë këmbimi i marrësave analogë me ata numerikë. Më e ndjeshme kjo në tranzicion, kur në efir do të bashkëjetojnë, si sinjalët analogjike, ashtu dhe ata numerike. Duke patur tashmë në dispozicion marrësa analogë, shikuesi do të bindet të blejë marrës numerik apo set top box (decoder), vetëm nëse oferta e programeve do të jetë térheqëse. Zgjatja e tranzicionit do të varet nga shpejtësia e përhapjes së marrësave numerikë në treg. Në fazën e parë, për të lehtësuar shpenzimet për marrjen e sinjaleve numerike, në vend të marrësit numerik, përdoruesit do të pajisen me një set-top-box për dekodifikimin e sinjaleve numerike. Vlefta e një pajisjeje të tillë, aktualisht është rreth 150 euro. Për të lehtësuar kalimin në numerik, ka shtete që subvencionojnë shpenzimet për blerjen e këtyre dekoderave. **Nuk mendojmë se në Shqipëri ekzistojnë kushtet që shteti të subvencionojet shitjen e set-top-box-eve.**
- Kalimi në numerik do të krijojë mundësi për një komercializim të plotë të shërbimit televiziv. Një fakt i tillë rrezikon që të lihen pas dore disa funksione publike, qofshin të vetë operatorit publik, qofshin edhe të operatorëve privatë.
- Ndërtimi i platformave numerike dhe ofrimi i kapaciteteve të tyre për ofruesit e përbajtjes (content provider), nxjerr në evidencë problemin e aksosit të këtyre ofruesve në platforma, i cili duhet të jetë i drejtë, i barabartë dhe jo diskriminues. Në kushtet e kapaciteteve akoma të kufizuar

- të platformave, KKRT duhet të përcaktojë kritere të sakta për të rregulluar aksesin.
- Diferenca në nivelin ekonomik midis shikuesve do të reflektohet në diferencë në nivelin kulturor e edukativ, pasi shikuesit me të ardhura të pakta do të privohen nga marrja e programeve të kriptuara, që presupozohet të jenë më cilësore, pra më të kërkua.

Aktualisht, nuk disponohen studime të sakta mbi shpenzimet që bëjnë qytetarët shqiptarë për shërbimet televizive (për shërbimet Ca-TV apo satelitore, pasi operatorët privatë analogë tokësore ofrojnë shërbimet e tyre pa pagesë direkte).

5.3.5 Konkluzion

Shqipëria është një vend në zhvillim me një sektor të transmetimeve radio e televizive të realizuar kryesisht me pajisje të vjetruara të teknologjisë analogjike dhe të ushqyer nga një treg i varfér reklamash.

Në Shqipëri nuk është përfunduar dhe nuk është zbatuar ende një plan i vërtetë i shpërndarjes së frekuencave radio e televizive analoge. Për përmirësimin e gjendjes (si të cilësisë së transmetimeve, shmangjes së interferencave dhe të mbulimit), sektori ka nevojë për investime të mëdha. Në veçanti, operatori publik duhet të bëjë investime të konsiderueshme edhe për të liruar brezin 81-88 MHz, që është brez i destinuar për shërbime të tjera.

Kryerja e investimeve të rëndësishme për ndërtimin e rrjeteve analoge, në një kohë kur shumë vende, përfshirë vendet fqinje, kanë intensifikuar investimet në teknikën numerike, mund të rezultojë jo efikase në një perspektivë afatmesme. Në këto kushte, rezulton imediate detyra për planifikimin e futjes së transmetimeve televizive numerike.

5.4. Modelet e rrjeteve numerike

Modelet e rrjeteve numerike më të përshtatshme për Shqipërinë mund të janë:

- Rrjete të planifikuara në nivel kombëtar jo të zbërthyeshëm në rrjete rajonale apo vendore, që u përgjigjen rrjeteve SFN;
- Rrjete të planifikuara në nivel kombëtar, të zbërthyeshëm në rrjete rajonale, të planifikuar me sistemin k-SFN, ku k është numri i frekuencave të përdorura;
- Rrjetet e planifikuara në nivel kombëtar të zbërthyeshëm në rrjete rajonale e lokale të realizuara sipas modelit MFN.

Rrjetet kombetare SFN garantojnë shfrytëzimin maksimal të spektrit të radiofrekuencave (ose më saktë, numrin e programeve përkundrejt frekuencave të përdorura), por ato nuk janë të zbërthyeshme në nivel rajonal apo vendor.

Rrjetet MFN janë rrjete kombëtare të zbërthyeshme në nivel lokal, por ato nuk lejojnë një shfrytëzim maksimal të spektrit, si në rastin e rrjeteve SFN. Çdo rrjet MFN përdor të paktën 3- 4 frekuencia.

Rrjetet 2-SFN dhe 3-SFN (ose rrjetet MFN me 2 apo 3 frekuencia me zgjatime lokale SFN) ofrojnë një kompromis më të mirë midis efektivitetit të përdorimit të spektrit dhe të zbërthyeshmërisë në rrjete rajonale e lokale.

Përfundimisht, struktura e Planit Numerik do të përcaktohet vetëm pas përcaktimit të kërkesave për rrjete kombëtare, rajonale dhe lokale. Një kombinacion i rrjeteve të tipeve të ndryshme do të japë rezultate të ndryshme përsa i përket numrit të rrjeteve dhe, për rrjedhojë, edhe të programeve që do të mbështeten mbi to.

5. 5. Tipologja e rrjeteve

Në përcaktimin e numrit të rrjeteve, rrjedhimisht dhe të programeve që do të mbështeten në to, do të ndikojë tipologja e rrjeteve që do të përcaktohet nga kërkesat e tregut. Në mënyrë të përbledhur, detyra që duhet të zgjidhet nga Plani Numerik do të jetë përcaktimi i numrit optimal të rrjeteve të realizuara në teknikën numerike, duke kombinuar tipat e studiuar më sipër të rrjeteve (SFN, k-SFM dhe MFN) për 4 kategoritë e mëposhtme të rrjeteve:

1. rrjet me shtrirje kombëtare
2. rrjet me shtrirje rajonale
3. rrjet me shtrirje 1 prefekturë
4. rrjet me shtrirje 1 rreth

Të gjitha rrjetet e përcaktuara më sipër do të janë rrjete të planifikuara në nivel Kombëtar, të pazbërthyeshëm për rrjetet kombëtare dhe të zbërthyeshëm në nivel rajonal për rrjetet me shtrirje rajonale (3 rajone), në nivel 1 prefekturë për rrjetet me shtrirje 1 prefekturë (12 prefektura), në nivel rrethi për rrjetet me shtrirje 1 rreth (35 rrethe).

5.6. Tregu i transmetimeve televizive numerike

Rrjet transmetimi i TV numerik tokësor është tërësia e impianteve transmetues që mbulon një territor të caktuar (zona e mbulimit) me 1 deri në 4 programe të njëjtë e të njëkohshme.

Teknologjia numerike do të sjellë avantazhet e mëposhtme:

- Shërbime e produkte të reja (kanale shtesë, platforma, shërbime interaktive). Si shërbime shtesë mund të përmenden: EPG (electronic program Guide), Pay TV, VOD (Video On Demand), NVOD,(Near Video On Demand) interaktivitet lokal, aplikacione interaktive, etj.

- Përmirësimin e parametrave të tregut (rritja e kapaciteteve sjell uljen e kostove
- Përfitime për publikun (përmirësohet administrimi i spektrit, rritet konkurenca)

5.7. Modeli i tregut numerik

Me futjen e teknologjisë numerike, aktorët e tregut do të jenë:

- Ofroesit e përbajtjes (Content Providers)
- Ofroesit e shërbimeve (Service Providers)
- Operatori i rrjetit (Network Operator)

Diversifikimi i ofertave të ndryshme (përbajtja, shërbimi dhe rrjeti) bën të mundur një specializim të ngushtë të operatorëve për secilin nga funksionet e përshkruara, duke rritur përkatësisht cilësinë dhe duke forcuar konkurrencën.

6. PRECEDÉNTI DIGITALB

Duke qenë se transmetimet numerike, edhe pse ende të parregulluara, kanë hyrë në Shqipëri, duke qenë se kjo përbën tanimë edhe një fushë përparësore, duke qenë gjithashtu se ka një precedent që, përfat të keq është shoqëruar edhe me efekte keqësuese, duke qenë së fundi se në këtë angazhim u përfshinë, qoftë dhe për momentin, figura të njoitura të politikës; përkthim i arsyeshëm kërkohet mirëkuptim për një trajtim më në detaje të precedentit në fjalë, thjesht me qëllimin e një njojeje më të zgjeruar.

Në fillim të vitit 2004, TV "Top Channel" paraqiti pranë KKRT-së kërkesën⁵ për t'u licencuar si operator për transmetime televizive numerike tokësore dhe paralelisht, pa pritur përgjigje për kërkesën e bërë, ky subjekt filloi një fushatë intensive propagandistike për reklamimin e shërbimit të ri. Në përgjigjen e KKRT-së⁶ deklarohej mbështetje për nisma të tilla që modernizojnë teknologjinë e transmetimit në Shqipëri, kur këto janë në përputhje me ligjet, ndaj në funksion të masave që KKRT kishte menduar për transmetimet numerike tokësore në territorin e Shqipërisë, bëhej ftesa për bashkëpunim në përgatitjen e kuadrit rregullues ligjor. Ndërkakq tërhiqet vëmendja:

- *të mos kryheshin investime, pa u licencuar paraprakisht konform ligjit, pasi, në rast moslicencimi, rrezikoheshin ato.*
- *të mos tregtoheshin dekodera për të marrë shërbime të palicencuara.*
- *të mos transmetoheshin reklama për shërbime të palicencuara*⁷

Letra e mësipërme e KKRT-së nuk u vlerësua nga "Top Channel", që vazhdoi me intensitet fushatën promocionale, ndryshe nga subjekte të tjera, cilët edhe ata kishin depozituar kërkesa të njëjtë, por që u tërroqën përballë po të njëjtës përgjigje që kishin

⁵ Shkresë e "Top Channel", datë 21.01.2004 dhe 23.03.2004, drejtuar KKRT-së

⁶ Letra e KKRT-së, nr. 355, datë 26.03.2004

⁷ Po aty

marrë nga KKRT.⁸ “Top Channel”, pasi okupoi arbitrarisht kanalet 62, 64, 67 dhe 69 në brezin UHF, në rajonin e Tiranës, filloi transmetimet, dhe së fundi, publikoi datën 15 Korrik 2004, si ditën e lëshimit të shërbimit të ri “Dixhitalb”.

I shqetësuar për precipitimin e situatës, KKRT iu drejtua përsëri "Top Channel-it" me një letër, ku e këshillonte të mos nxitohej në çeljen e këtij shërbimi, në ditën e caktuar arbitrarisht, pasi, përvèç të tjerash:

"KKRT është e shqetësuar, pasi impakti i veprimeve tuaja shtrihet në të gjithë sektorin e transmetimeve televizive, duke krijuar disbalancime të tregut, në dëm të operatorëve të tjera, të cilët, në zbatim të Kushtetutës dhe dispozitave të ligjit "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë" duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë, jo diskriminuese e transparente. Duke instaluar, pa licencë, transmetues dixhitalë dhe duke okupuar arbitrarisht kanalet UHF të përmendura më sipër, ju keni shkelur të drejtat e subjekteve që kanë aplikuar dhe janë skualifikuar nga KKRT, mbështetur në rregullat që janë transparente dhe të njëjtë për të gjithë. Gjithashtu, instalimi i transmetuesve të paautorizuar vë në rrezik zbatimin e planit të migrimit të frekuencave, i cili do të përmirëson rrënjesisht cilësinë e transmetimeve nga Dajti, duke zhvlerësuar kështu, perfundimisht, dhe masat e ndërmarra nga të dhënat e hartës së frekuencave për transmetime radiotelevizive¹⁰".

Në përgjigje të letrës së cituar më sipër, "Top Channel" intensifikoi reklamën për këtë shërbim të palicencuar, duke u premtuar qytetarëve larmi programesh me cilësi të lartë, ndërsa në datën 15 "Digitalb" filloj shitjen e dekodereve në disa pika shërbimi në Tiranë. Sipas tyre, "Digitalb" ishte një shoqëri e re që po ofronte shërbime, të cilat nuk ishin objekt i ligjit "Për radion e televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë" dhe për këtë arsyen nuk i ishte drejtuar KKRT-së, as formalisht. KKRT, në kushtet e blokimit institucional (3 nga anëtarët kishin përfunduar mandatin në muajin Qershor 2004), që bënte të pamundur vendimmarrjen, pra, ndërmarrjen e sanksioneve të parashikuara në ligj, në datën 15.07.2004 doli me një njoftim për shtyp ku, pasi theksohen gatishmëria e KKRT-së për nxitjen e zhvillimit dhe mbështetjen e përpjekjeve përfundimtare futjen e teknologjisë së re, theksohej:

"Pranë KKRT-së, nga subjekte të ndryshme janë paraqitur disa kërkesa për licencë për instalimin e rrjeteve televizive numerike tokësore në Shqipëri, siç ka paraqitur, ndër të parët edhe operatori i mirënjojohur televiziv Top Channel. Në përgjigje (për Top Channel me tonat nr. 355, datë 26.03.2004 dhe nr. 715, datë 09.07.2004) KKRT kërkon mirëkuptimin e tyre për hartimin e kuadrit rregullator dhe ndryshimet e domosdoshme në ligj, për çështje të paparashikuara nga legjislacioni ekzistues dhe i fton ata të bashkëpunojnë për shpejtimin e procesit. Ndërkaq, Digitalb, një subjekt me status të panjohur nga KKRT, por me linja të qarta bashkëpunimi me Top Channel, njofton fillimin e shërbimit, pa aplikuar, pa iu përgjigjur kërkesave tona për informacion plotësues, në

⁸ Letra nr. datë e KKRT drejtuar TV "Koha"

⁹ Letra e KKRT nr. 715, date 09.07.2004

¹⁰ Po aty

kundërshtim me çdo procedurë ligjore për fillimin e një biznesi qfarëdo, aq më tepër në fushën e transmetimeve radio e televizive”¹¹

Më poshtë, në njoftimin për shtyp përcaktoheshin disa nga pengesat ligjore që e bënин të pamundur licencimin e “Digitalb”-it:

a) çdo subjekt që ka një licencë për transmetim televiziv nuk mund të ketë një licencë të dytë (neni 20),

b) për çdo subjekt që instalon pajisje radio ose televizive, duke dalë në transmetim në efir me figurë e zë pa autorizimin, licencimin e KKRT-së, ligji parashikon gjobë deri në mbylljen e sekuestrimin e pajisjeve (neni 137/2, 137/4),

c) çdo subjekt është i detyruar të depozitojë dokumentacionin që vërteton të drejtat e transmetimit mbi programet, (ligji nr. 9124, datë 29.07.2003), etj”¹².

Pasi bëheshin të qarta çështjet që kërkonin zgjidhje ligjore KKRT kërkoi njëherësh ndërprerjen e këtij shërbimi të paautorizuar dhe e ftoi subjektin të bashkëpunojë për kontribuar në zgjidhje ligjore, pasi:

“Precedenti i daljeve të paautorizuara, në emër të teknologjive të reja, pa kuadrin rregullues e procedura të ligjshme, do të çrrregullonte që në fillim përpjekjet për një strategji zhvillimore të mediave elektronike, do të rikthente kaosin në përdorimin e brezave të frekuencave për transmetime radiotelevizive, duke prekur rëndë interesat e vetë komunitetit të mediave, por edhe të qytetarëve tepër të interesuar për programe më cilësore”¹³.

Sic pritej, njoftimi për shtyp nuk u mor parasysh dhe “Digitalb”-i vazhdoi ofrmin e shërbimit, shitjen e dekoderave dhe intensifikimin e spoteve publicitare, duke përdorur kryesisht hapësirat e TV “Top Channel” dhe radios “Top Albania”. Ndërkakq, një fushatë e ashpër kundër KKRT-së u ngrit edhe në disa të përditshme të shtypit të shkruar me klishe të parapërgatitura për rolin pengues të KKRT-së, pa u ballafaquar me argumentet. “Top Channel” thirri në ndihmë edhe figura publike, sidomos të politikës, të cilët pa ngurim u vunë në krah të Digitalbit dhe kundër KKRT-së.

Në kushtet e pamundësisë për të marrë vendime, KKRT u përpoq të sensibilizonte opinionin publik, organizmat shtetërore e ndërkombëtare mbi precedentin “Digitalb” dhe pasojat në tregun shqiptar të transmetimeve radio e televizive. Në deklaratën për shtyp që z. Sefedin Çela dha në dorëheqjen e tij nga posti i Kryetarit të Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizonit, ndër të tjera e vuri në dukje se:

“I gjithë procesi, deri në vendimmarrje, ka nevojë për ekspertim e transparencë të plotë, pasi për të janë të interesuar jo vetëm komuniteti i medias, por veçanërisht dhe qytetarët. Vetëm kështu ligjvënësi, me amendimet në ligj, do të krijojë hapësirën e nevojshme për nxitjen e investimeve në këtë fushë, që fillimisht e shohim si eksperimentale.”¹⁴,

¹¹ KKRT-Njoftim për shtyp 15.07.2004

¹² Po aty

¹³ Po aty

¹⁴ Sefedin Çela-Deklaratë për shtyp 28.07.2004

Po në atë deklaratë u përmend edhe se

“KKRT ka deklaruar në Kuvend se vendime të rëndësishme, përfshi dhe dokumentin e strategjisë së zhvillimeve rtv dixhitale tokësore, do t'i kalonte për vendimmarrje pas rikonstituimit të institucionit, me përfaqësim adekuat e me mandat të ri, duke e vlerësuar këtë si një akt të përgjegjshëm, larg interesave të veta e plotësish të moralshëm të anëtarëve që përfunduan mandatin. Shembujt e bashkiakëve, që japid leje ndërtimi e sheshe ndërtimi në fund të mandatit, janë shokues për të gjithë.”¹⁵

Në mbledhjen e parë zyrtare të Këshillit të ri të rikonstituar, ku për herë të parë ishte plotësuar vendi i lënë vakant nga opozita prej fillimit të mandatit të parë, u diskutuan dhe u miratuan projekti i Strategjisë së Zhvillimit të Transmetimeve Radio e Televizive dhe projektligji për ndryshimin e ligjit “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë” për futjen e transmetimeve numerike tokësore. Këto dy dokumente janë dërguar për mendim Komisionit Parlamentar të Mjeteve të Informimit Publik, Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Transportit dhe Telekomunikacioneve, Ministrisë së Ekonomisë, Ministrisë së Financave, Entit Rregullator të Telekomunikacioneve, Radiotelevizionit Publik Shqiptar, Shoqatave të operatorëve radiotelevizive, Zyrës së Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, Delegacionit të Komisionit Evropian në Shqipëri, Zyrës së Këshillit të Europës në Shqipëri, IREX dhe Institutit shqiptar të mediave. Gjithashtu, dokumenti i Strategjisë është dërguar për ekspertizë edhe pranë Departamentit të Mediave në BE. Duke iu dhënë Institucioneve e organizmave të përmendura më sipër kohën e nevojshme për shqyrtimin e këtyre dokumenteve, KKRT planifikoi të organizojet një tryezë të rrumbullakët ku do të diskutohen çështjet më të rëndësishme që duhet të zgjidhen për përcaktimin e rrugëve optimale për futjen e transmetimeve numerike tokësore në Shqipëri. Tryza parashikohet të mbahet në Mars 2005.

Për kalimin e këtyre dokumenteve të rëndësishme do të duhet koha e nevojshme. Ndërkaq, “Digitalb” vazhdon të funksionojë duke ofruar shërbim pa licencë, pa paguar detyrimet, qoftë për shërbimin që ofron, qoftë për frekuencat e okupuara. Sigurisht janë bërë edhe investime dhe kjo është një çështje që u përket të zotëve të punës. Por KKRT, si strukturë e përgjegjshme dhe e motivuar për nxitjen e teknologjisë në fjalë, është e interesuar jo të shkatërrojë por të rregullojë, të ndreqë sa të jetë e mundur atë çka është bërë dhe është duke u bërë keq. Ligji i paraqitur tashmë me veprim të përkohshëm “Për eksperimentimin e transmetimeve numerike” është në dobi të këtij preokupimi, ndërsa çdo veprim tjetër dhe galopet në hapsira të paligjshme, loja me faktin e kryer do të gjejë përgjigjen korrekte kundërshtuese dhe vepruese të institucionit rregullator.

I konceptuar si eksperiment, KKRT do të bashkëpunojë me atë ose ata që e marrin përsipër eksperimentin, më i mundshmi Digitalb, duke modeluar kontratën përkatëse dhe fazat e eksperimentit, i cili do të hapë rrugë që zhvillimet e ardhshme të janë më të sigurta.

¹⁵ Po aty

Eksperimenti si i tillë do të jetë i kufizuar në shtrirje dhe frekuencat e vëna në dispozicion. Cdo privilegj do ta deformonte qëllimin e eksperimentit dhe më keq ende do të deformonte subjektivisht tregun, duke krijuar pozita dominuese, te papranueshme për standartet e sotme.

7. TELEVIZIONI PUBLIK DHE NUMERIZIMI I RRJETEVE TE TRANSMETIMEVE TELEVIZIVE TOKESORE

7.1 Gjendja

Televizioni Publik Shqiptar (TVSH) me anën e një rrjeti transmetuesash e përsërítësash, mbulon 73.3 % të territorit të Shqipërisë me 1 program të mbështetur në sinjal analogjik tokësor.¹⁶ Ligji “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë përcakton:

“Programet e RTSH-së duhet të mbulojnë territorin e banuar nga të paktën 90 përqind e shtetasve të Republikës së Shqipërisë.”

Brenda 5 vjetësh nga dita e miratimit të këtij ligji, të paktën njëri nga programet e RTSH-së duhet të mbulojë 99 përqind të popullsisë”¹⁷

Nga objektivat siç shihet, mbetet i paarritur i dyti (ai 99 për qind i popullsisë), ndërsa për programet mabetet për t'u realizuar programi i dytë. Për transmetimin e programit të dytë kombëtar, KKRT i ka vënë në dispozicion RTSH-së një kanal në rajonin e Tiranës, që aktualisht përdoret për transmetimin e programit të parë.

Programi i parë kryesisht mbështetet në një transmetues që transmeton nga mali i Dajtit në brezin 81-88 MHz. Sinjali i emetuar nga ky transmetues shërben si sinjal primar për gjithë rrjetin e përsërítësave të RTSH-së, që mbulon gjithë vendin. Për shkak të karakteristikave të përhapjes në bandën 81-88 MHz, mbulimi i zbatuar në këtë menyrë është më i gjerë në krahasim me mbulimin me zëvendësim të këtij transmetuesi me një tjetër në brezin VHF, apo në UHF. Plani Kombëtar i Radiofrekuencave, i miratuar nga Këshilli i Ministrave, ka përcaktuar lirimin, brenda vitit 2002 të brezit 81-88 MHz, pasi edhe sipas rekomandimeve të ITU, ky brez përdoret për shërbime të tjera. Zëvendësimi i këtij transmetuesi përbën një investim të konsiderueshmë për TV publik, pasi përvcq tij, është një rrjet i tërë përsërítësash që duhen modifikuar për të pranuar si sinjal primar një sinjal në VHF (ose dhe UHF) në vend të sinjalit në bandën C (81-88 MHz).

7.2 Numerizimi i rrjetit te RTSH

Nga të gjitha organizmat e specializuara evropiane, shërbimi i transmetimeve publike radio e televizive, shihet thelbësor për kohezionin e shoqërive demokratike. Prej tyre rekomandohet me këmbngulje që ky rol të zhvillohet edhe në ambientin e ri numerik.¹⁸

¹⁶ KKRT-Raporti Vjetor 2003, fq 25.

¹⁷ Ligji “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, nen 71

¹⁸ Në rekomandimin Rec (2003) 9 të Këshillit të Ministrave të Shteteve Anëtare mbi Masat për të promovuar Kontributin demokratik e Social të Transmetimeve Numerike, rekomandohet që qeveritë e

Ndaj, siç po shihet në mjaft vende të Evropës, numerizimi i operatorit publik, përbën themelin e numerizimit të transmetimeve radio e televizive të një vendi.

Në kushtet kur RTSH-së i nevojiten fonde:

- a. për ndërrimin e rrjetit që do të mbështesë programin e dytë;
- b. për lirimin e brezit 81-88 MHz;
- c. për mirëmbajtjen e rinoimin e rrjetit të konsumuar ekzistues,

mendojmë se duhet të **shqyrtohet mundësia që, në vend të ndërtimit të rrjetit analog për programin e dytë të RTSH-së, të ndërtohet një rrjet numerik, mbi të cilin do të mbështeten, në perspektivë, si programi i parë, ashtu edhe programi i dytë**. Ky shqyrtim i shoqëruar me një *feasibility study* duhet të kryhet nga vetë specialistët e RTSH-së, të mbështetur edhe në ekspertizë të huaj.

Ndërtimi i rrjetit numerik të operatorit publik do të planifikohet pjesë-pjesë, duke filluar në mënyrë eksperimentale në një zonë të caktuar (ndoshta zona e Tiranes) dhe duke u perhapur gradualisht, deri ne mbulimin e territorit te vendit. Në këtë mënyrë, operatori publik do të ketë në dispozicion, në vend të dy programeve, 4 deri në 6 të tilla. Për të siguruar shërbimin universal, programet e operatorit publik do të transmetohen të hapura. Për periudhën e tranzpcionit, transmetimet e programit të parë nëpërmjet rrjetit numerik tokësor, do të realizohen njëkohësisht (simulcast) me transmetimet e po këtij programi në rrjetin analog tokësor. Transmetimet në simulcast do të vazhdojnë derisa, ndoshta 90 për qind e shikuesve, (përqindja duhet të përcaktohet pas miratimit të strategjisë së zhvillimit të transmetimeve numerike tokësore) të jenë pajisur me marrësa numerikë apo dekodere. Vetëm pas arritjes së këtij kufiri, transmetimet analoge do të mbyllen, duke liruar frekuencat që kanë pasur në përdorim.

Marrja e vendimit për ndërtimin e rrjetit numerik publik është një përgjegjësi që duhet të përligjet me përmirësimin e bilancit ekonomik të operatorit publik, si dhe me ngritjen e nivelit cilësor të programeve e fuqizimin e shërbimeve për publikun e gjerë. U përket strukturave drejtuese të Radiotelevizionit Publik Shqiptar, të vlerësojnë gjendjen dhe të inicojnë vendimmarjet përkatëse, përfshirë edhe ato të buxheteve të domosdoshme. Në vështrim të detyrës sonë është se Strategjia e pritshme e Transmetimeve Radiotelevizive në Shqipëri, si pjesë e saj Strategjia e Transmetimeve Tokësore Numerike, e ka të domosdoshme të verë në qendër të vet zbatimin përparësor dhe me tregues model në radhë të parë, pra mbi të gjithë, transmetuesin publik të vendit.

Vendeve Anëtarë të marrin në konsideratë parimet e pasqyruara në aneksin e këtij rekomandimi. Ndër të tjera, në Rekomandim theksohet:

-
- e. të garantohet që shërbimi publik i transmetimeve rtv, si një faktor esencial për kohezionin e shoqërive demokratike, të ruhet në ambientin e ri numerik nëpërmjet sigurimit të aksesit universal të individëve në transmetimet e operatorëve publikë, duke i dhënë atij, *ndërmjet të tjera* një rol qëndror në tranzpcionin drejt transmetimeve numerike;
 - f. të riafirmohet misioni i transmetimeve publike, duke ia përshtatur, nëse është e nevojshme, instrumentet e tij, ambientit të ri numerik, lidhur me parimet bazë kryesore të vendosura në tekstet e mëparshme të Këshillit të Europës, duke vendosur kushte financiare, teknike e të tjera, që do ta lejojnë atë të plotësojë këtë mision sa më mirë të jetë e mundur.

8. BASHKEPUNIMI ME KUVENDIN, QEVERINE DHE ORGANET E TJERA

8.1. Roli i organeve legjislativë dhe qeverisës

Produktet e tregut radio e televiziv i drejtohen publikut te gjere dhe perbejne një element thelbësor ne jeten politike, ekonomike e sociale te vendit. Ne shoqerine e hapur demokratike, roli i tyre eshte i pakontestueshem ne promovimin e vlerave kulturore, didaktike e argetuese dhe per informimin nepermjet disa burimeve. Per kete arsye keto produkte gezojne një status te vecante dhe rregullimit, mbikqyrjes e promovimit te tyre i kushtohet rendesi ne cdo vend. Ne kete proces marrin pjese shume hallka te struktura se shtetit: Parlamenti, Qeveria, organet e pavarur rregullatore, shoqatat e operatoreve, etj. Vetem nepermjet një bashkeveprimi dinamik midis ketyre hallkave mund te arrihet sigurimi i vlerave thelbësore te një shoqerie demokratike qe jane: pluralizmi, transparensa, mosdiskriminimi, mbrojtja e te drejtave te njeriut, te te miturve, mbrojtja e te drejtave te autorit, etj.

8.2 Bashkepunimi me Kuvendin per vitin 2004

Me detyrimin e institucionit rregulator për të monitoruar veprimtarinë transmetuese radiotelevizive dhe me detyrimin për të raportuar çdo vit për këtë detyrim në zbatim të ligjit, vërejmë se mbikqyrja e kësaj veprimtarie dhe rregullimet e kohëpakoreshme nga Kuvendi në tërësinë e vet kanë ardhur duke u përmirësuar. Në këtë kontekst, na duhet të shprehim se Këshilli mbetet gjithnjë i vemendshëm në marrëdhëni e tij me Kuvendin dhe strukturat e tij, jo thjesht në kuptimin procedural formal, por në angazhimin e ndërsjellë për detyrime të përbashkëta. Disa nga shpjegimet që u dhanë më lart lidhen me këto marrëdhnie. Sa për referencë, në raportin e paraqitur vitin e kaluar është përmendor puna përgatitore edhe për Planin e Frekuencave Dixhitale Tokësore duke u cituar se “*Bazuar ne punen pergaçitore te zhvilluar dhe qe do te zhvillohet gjate vitis 2004, mendojme se brenda ketij viti, KKRT do te jete ne gjendje te autorizoje rrjetet e para eksperimentale televizive dixhitale tokesore*”¹⁹. Miratimi në vetëvete i atij Raporti mbart detyrimet e shprehura. Nisma për rregullimin në formë eksperimenti, tashmë të paraqitur, është në plotësim të këtij detyrimi.

Por jo vetëm kaq. Pavarësisht ndonjë rasti devijues, praktikat e tanishme të marrëdhënieve Kuvend me institucionin rregulator i verejmë thelbësisht korrekte. Sot nuk është koha kur në Shqipëri kishte hyrë media elektronike, por ende nuk kishim një autoritet rregullues, si strukturë përgjegjëse dhe e kualifikuar. Kësisoj, jo në anën formale, por përbajtësore, nuk përligjen nisma ligjvënëse imponuese, ngado që të vijnë ato, duke u anashkaluar struktura rregullatore zbatuese. Koregjimet proceduriale që u bënë më pas në rastin e projektit për eksperimentin e transmetimeve numerike, praktika që pritet të ndiqet edhe në ditët që vijnë në procesin e përgatitjes përfundimtare te projektit në komisionin përkatës të

¹⁹ KKRT-Raporti Vjetor, 2003

Kuvendit parakuptojnë këto marrëdhënie të afërtë e të pashkëputura. Cdo hallkë e këputur në këtë funksionim do të sillte efekte keqësuese, klauzola ndërhyrëse të pastudjuara dhe me interferenca interesash të ngushta dhe do të vështirësonte jo vetëm punën e rregullatorit por edhe fushën në tërsi.

Brenda këtij parashtrimi, do të dëshironim të sillnim në vëmendje se ende kanë mbetur pezull çështje të ngritura ose të shtruara, por të paçuar që fund; ashtu sikurse angazhimet e vendit dhe të strukturave të shtetit në kuadrin e marrëveshjes për hapjen e negociatave me BE-në shtrojnë disa detyrime imperative, të cilave u duhet përgjigjur. Kështu duhet të marrin udhë disa ndryshime të tjera në ligjin 8410 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, ndryshime që duhet vendosin rregull në hapsirat e transmetimit për operatorët, duhet të bëhen rregullime në paragrafët për pronësinë e mediave dhe transparencën e burimeve të të ardhurave, deri edhe çështje për një pavarësi më të avancuar të rregullatorit. Pjesë e saj janë edhe rregullimet në fushën e frekuencave dhe marrëveshjet me organizmat ndërkombëtarë të specializuar.

8.3 Bashkëpunimi me organet qeveritare

KKRT eshte organ i pavarur nga qeveria, por pjesë dhe në radhë me strukturat e tjera të shtetit. Bashkëpunimi me këto struktura dhe me vetë qeverinë është e domosdoshme. Në thelbin e vet bashkëpunimi është rregulluar me ligj, por si në çdo rast tjetër, kompleksi i marrëdhënieve është më i gjërë nga sa shprehet ligjërisht. Bashkëpunimi me organe si ato fiskale, me Entin Rregulator te Telekomunikacioneve etj., është duke u zgjeruar dhe mirëkuptimi vjen në rritje. Marrëdhënie më të afërtë e pretenduese janë krijuar vitin që shkoi edhe me Ministrinë e Integrimit Evropian duke u idenifikuar detyrat dhe kryer veprimtaritë perkatëse në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit, një pjesë prej të cilave, detyrat afatshkurtra, janë përfshirë edhe në planin e veprimit pët vitin 2005.

Sic permendet ne hyrje te ketij raporti, KKRT do te percaktoje afatet e shkeputjes se buxhetit te KKRT nga financimet shteterore. Nje ide eshte hedhur qe ky afat te jetë fundi i vitit 2008. Nderkaq, sic u theksua, buxheti i shtetit per vitin 2005 nuk parashikon asnjë financim per KKRT. Nje shkeputje e tille e menjehershme e pa paralajmerim, e ve KKRT ne një pozite te pafavoreshme. Ketu nuk behet fjale per te siguruar fondet e pagave dhe shpenzimet e tjera te nevojshme per punen e perditeshme te administrates, por per financimin e zhvillimit jo vetem te institucionit, por te gjithe sektorit. KKRT ka nevoje te stabilizoje ambientet e punes, te siguroje mbeshtetjen financiare per ngritjen e grupit teknik te punes per hartimin e planit te frekuencave numerike, ne kuadrin e perqatitjeve per sesionit te dyte te Konferencies se Gjeneves RRC-06.

9. DETYRIME NE RAPORT ME ORGANIZMA NDERKOMBETARE TE FUSHES

Edhe pse ende nuk janë vendosur deri në fund marrëdhëni me të gjithë homologët kryesorë të vendeve të tjera dhe me organizma të kësaj fushe, gjithësesi janë bërë hapa progresivë në funksion të zgjerimit të këtyre lidhjeve. Pjesëmarrja në veprimitari të ndryshme është më e shpeshtë dhe më të konkretizuara detyrimet të cilave duhet t'u përgjigjemi. Për detyrime informimi ndaj Kuvendit dhe për arsyen e angazhimeve që rrjedhin që andej veçojmë pjesëmarrien nga 10 deri ne 28 Maj 2004 ne Konferencen Rajonale të Radiokomunikacioneve per planifikimin e sherbimit te transmetimeve numerike tokesore ne pjese te Rajoneve 1 dhe 3 ne brezat e frekuencave 174-230 dhe 470-862 MHz. Per te perfaqesuar Republiken e Shqiperise, si vend antar i Bashkimit Nderkombetar te Telekomunikacioneve (ITU) qe shtrihet ne Rajonin 1, ne Konference, me mandat plotfuqishmerie te neneshkruar nga Ministri i Jashtem z. Kastriot Islami, mori pjese nje delegacion i perbere nga perfaquesues te Ministrise se Transportit dhe Telekomunikacioneve dhe KKRT.

9.1. Origjina dhe qellimi i RRC 04-06

Keshilli i ITU, ne sesionet e tij ne 2001 dhe 2002, ka adoptuar rezolutat 1185 dhe 1180 me ane te te cileve eshte pranuar mbledhja e nje Konference Rajonale te Radiokomunikacioneve (RRC) mbi planifikimin e transmetimeve tokesore ne brezat VHF/UHF per nje zone planifikimi te kombinuar, qe mbulon Zonen Evropiane te Transmetimit (EBA), zonen Afrikane te Transmetimit dhe vendet jashte Zones Afrikane te Transmetimit qe jane pale te Marreveshjes Rajonale te Transmetimit, Gjeneve 1989.

Konferanca e plotfuqishme, Marrakesh 2002, e mori gjithashtu ne konsiderate kete ceshtje dhe vendosi te zgjeroje zonen e planifikimit mbi territoret e vendeve te me poshtme qe nuk mbulohen apo mbulohen pjeserisht nga zonat e planifikimit te Marreveshjeve ST61 (Stockholm '61) dhe GE89 (Gjeneve '89): Armenia, Azerbjaxhani, Gjeorgji, Kazakistan, Federata Ruse (pjesa e territorit ne perendim te gjatesise 170° E), Taxhikistani, Turkmenistani, dhe Uzbekistani (shih Rezolutan 117 (Marrakesh, 2002)).

Ne menyre te permblodhur, zona e planifikimit perfshin ato pjese te Rajonit 1 qe jane te vendosura ne perendim te meridianit 170° Lindje dhe ne veri te paralelit 40° Jug, si dhe territorin e Republikes Islamike te Iranit.

Ne perputhje me keto Rezolucione u vendos qe Konferencia te mblidhej ne dy sesione:

- Sesioni i pare, i cili u mblodh ne Gjeneve prej 10 ne 28 maj 2004 per te vendosur bazat teknike per punimet e sesionit te dyte te RRC, perfshire bazat e nevojshme per te thjeshtuar ushtrimin e planifikimit perpara sesionit te dyte te RRC dhe formen ne te cilen do te paraqiten kerkesat e administrative.
- Sesioni i dyte, i cili pritet te mbahet ne 2006 do te vendose marreveshjen (apo marreveshjet) e re (reja) e shoqeruar nga plani perkates i frekuencave per transmetimet digitale tokesore ne brezat e frekuencave 174 deri ne 230 MHz dhe 470 deri ne 862 MHz.

9.2. Bazat e marreveshjes

Mandati i Konferencës RRC-04/06 mbalon vetem brezat III, IV dhe V (Sic jepet në Rezolutan 1185 (te modifikuar 2003) te Keshillit te ITU). Rrjedhimisht dhe brenda termave të Rezolutes 1185 (te modifikuar 2003), RRC do te vendose një marreveshje te re rajonale per keto breza. Një marreveshje e re do te beje qe pjese te konsiderueshme te Marreveshjeve ST61 dhe GE89 te rishkohen.

Marreveshja e re do te perbehet nga një pakete procedurash, kriteresh teknike dhe planet perkatese te frekuencave. Eshte evidente qe marreveshja e re do te permbaje planin e ri per transmetimet digitale (numerike) ne brezat II, IV dhe V. Pervec kesaj, dhe pavaresisht nga opzioni i adoptuar lidhur me qellimin e marreveshjes se re, do te linde nevoja e percaktimit te marredhenieve midis planit te ri (per transmetimet numerike) dhe perdorimeve te tjera te planifikuara (kryesish per televizionin analogjik), sic reflektohet ne planet qe shoqerojne marreveshjet ST61 dhe GE89.

Ne marreveshjen e re duhet te parashikohen edhe disa dispozita administrative, me qellim qe te ofrohet një kuadër i pershtatshem per tranzitimini nga transmetimi analog ne ate numerik. Per implementimin e RRC-04/06 do te linde nevoja per te percaktuar mekanizma te pershtatshem per revizionimin apo abrogimin e disa pjeseve te Marreveshjeve ST61 dhe GE89. Eshte propozuar qe kjo te behet nepermjet Konferencave te shkurtra te vecanta te lidhura me sesionin e dyte te RRC-04. Ne keto Konferencia do te marrin pjese vetem Shtetet Antare qe kane neneshkruar marreveshjet perkatese, te cilet do te neneshkruajne instrumente te vecante per kete qellim.

9.3. Detyrat imediate ne zbatim te rezolutave te Konferencës

Shqiperia eshte vend antar i Bashkimit Nderkombetar te Telekomunikacioneve dhe shtrihet ne zonen e planifikimit te planit te ri rajonal per sherbimin tokesor numerik, ne brezat e frekuencave 174-230 MHz dhe 470-862 MHz. Prej ketej lind domosdoshmeria e pjesmarrjes se saj aktive ne hartimin e një marreveshje te re qe do te revizionoje marreveshjen e Stockholmit 1961, ku fatkeqesish, perfaqesuesit e saj nuk kane marre pjese. Rezolucionet, vendimet e te cileve jane sjelle ne kapitullin paraardhes (4), dhe qe u miratuan me konsensus te plote nga te gjithe pjesemarresit, percaktojne një seri detyrash komplekse, te veshtira, qe kerkojne kualifikim te larte e qe duhen kryer ne koordinim te plote me vendet fqinje e me vendet e tjera antare, sipas një afati kohor, tashme te percaktuar ne detaje²⁰ nga sesioni i pare i RRC-04. Keshilli Kombetar i Radios dhe Televizonit, si administrues i percaktuar nga ligji²¹, i brezit te frekuencave per transmetime radio e televizive, ku bejne pjese edhe brezat 174-230 MHz dhe 470-862 MHz, do te jete institucion i kryesor i perqatitjes se bazave tekniko organizative te marreveshjes se re e cila me pas do te ratifikohet edhe nga organet perkatese shteterore. Per realizimin e një detyre te tille do te kerkohet edhe bashkepunimi i ministritve dhe organizmave te tjere shteterore qe kane lidhje, sidomos me Drejtoren e Pergjithshme PT

²⁰ Shih Rezoluten [COM5/1] dhe Aneksin 2 te saj

²¹ Shih ligjin "Per radion dhe televizionin publik e privat ne Republiken e Shqiperise" dhe ligjin "Per Telekomunikacionet ne Republiken e Shqiperise"

dhe ERT, kjo e fundit e pazevendesueshme ne pergatitjen e parashikimeve per mbrojtjen e sherbimeve te tjera primare nga futja e transmetimeve numerike tokesore dhe anasjelltas.

Detyrat kryesore qe u percaktuan deri ne arritjen e marreveshjes se re rajonale, qe pritet te ndodhe ne sesionin e dyte te RRC (tremujori i dyte 2006), listohen me poshte:

1. Informimi i qeverise mbi zhvillimin e sesionit te pare (RRC-04) dhe planin e aktiviteve qe do te zhvillohet ne periudhen intersesionale, deri ne arritjen e marreveshjes se re;
2. Masat per krijimin e Grupit Teknik te punes per hartimin e planit te frekuencave numerike, ne perberje te departamentit teknik te KKRT;
3. Organizimi, instruktimi e trainimi i antareve te grupit te punes, ne bashkepunim te ngushte me BR, ERO, etj;
4. Hartimi i planit te veprimit per organizimin e takimeve me administratat me vendet fqinje per kembim experience, koordinimin e frekuencave, sic rekomandohet;
5. Masat per te siguruar pjesmarrjen e perfaquesuesve te KKRT ne takimet qe do te organizohen ne periudhen intersesionale (IPG, RPG, Workshop, etj) ne perputhje me Rezolutan [COM5/1];
6. Vendosjae lidhjeve te qendrueshme institucionale me Grupin Drejtues te IPG dhe BR per te koordinuar asistencen per hartimin e planit kombtar te frekuencave numerike (Rezoluta[COM5/1]);
7. Caktimi i pikes se kontaktit te KKRT per koordinimin e veprimeve me per hartimin e planit te frekuencave per transmetime numerike tokesore.(Rezoluta [COM5/1],)

Shqyrtimi i një viti veprimtarie në median elektronike, si viti 2003, shtrirja e saj dhe rritja e prezencës, si numër operatorësh, si sinjal dhe si informacion në të gjithë territorin e vendit, plotësimi përherë e më i mirë i standardeve në fushën e programeve, të të drejtave të transmetimit, të teknologjive, por edhe të stafeve krijuese e teknike, flasin për konsolidim e qëndrueshmëri në tregun e mediave në tërsi, flasin për konsolidim edhe të KKRT-së, monitorues e rregullator i kësaj veprimtarie.

Pavarësisht se mediat elektronike, përvèç operatorit publik, janë biznese, KKRT ka patur kurdoherë parasysh se ato, njëkohësisht janë pasqyrë e proceseve demokratike, dimension i domosdoshëm i një shoqërie të hapur, pra, sjellja ndaj tyre dhe problemeve me to janë parë me tolerancë maksimale, duke aplikuar zgjidhjet në mirëkuptim, paralajmërimet e sanksionet e tjera, në kufijtë e ligjit.

Arritje të tillë si respektimi thuajse nga të gjithë operatorët radiotelevizivë i të drejtave të transmetimit, i paraqitjes së programeve me folës, titra apo dublim në shqip, shlyerja e detyrimeve financiare nga një numër përherë e në tritje operatorësh, si dhe pranimi prej tyre i domosdoshmërisë për rialokin e frekuencave që interferojnë, siç tregon Harta e Frekuencave dhe programimi i zgjidhjeve të paraqitura nga KKRT për të rregulluar gjendjen e rënduar, të gjitha këto tregojnë për zhvillime inkurajuese, të mbara, për operatorët e KKRT-në, por probleme të tjera janë ende tepër të mprehta.

Mediat e lira, posaçërisht ato elektronike, janë si një qënie që, për të qëndruar drejt, u duhet domosdoshmërisht të mbështeten në dy kembë: ligji dhe tregu. Harmonizimi i këtyre dy gjymtyrëve në çdo hap do ta bënte median të ecë e lirë, realisht e pavarur. Burimet e pamjaftueshme që siguron tregu i varfër e kaotik, posaçërisht ai i medias – pra reklama, e përpjeshuar në një numër të madh operatorësh, probleme të keqmenaxhimit edhe nga mungesa e përvjës, komprometojnë edhe sjelljen e respektin ndaj ligjit. Përballimi i këtyre problemeve, për të garantuar ecjen e sigurt të mediave, kërkojnë përpjekje të përbashkëta nga vetë komuniteti e nga rregullatori, si edhe nga ligjvënësi. Këto probleme do të janë objekt i këtij raporti, i informacionit plotësues dhe i Planit të Veprimit (bashkëlidhur) për vitin 2005, të cilat ia propozojmë këtij Kuvendi të nderuar t'i miratojë.

KKRT- KESHILLI KOMBETAR I RADIOS DHE TELEVIZIONIT**PLAN VEPRIMI PER VITIN 2005**

(Miratuar me Vendimin nr. 319, datë 28.01.2005)

Në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë,

Në zbatim të misionit të përcaktuar në nenin 6 të ligjit nr. 8410, datë 30.09.1998, "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", ndryshuar me ligjin nr. 8655, datë 31.07.2000, ndryshuar me ligjin nr. 8794, datë 10.05.2001"

Për rregullimin dhe mbikqyrjen e veprimitarise radiotelevizive në Republikën e Shqipërisë,

Në përputhje me kuadrin e përgjithshëm ligjor të Republikës

Bazuar në kompetencat e parashikuara në nenin 7 të ligjit të përmendur më sipër, KKRT, për vitin 2005, përcakton Planin e Veprimit si vijon:

1. Eksperimenti i transmetimeve numerike tokësore dhe i paketës së programeve satelitore

- a. Pjesëmarja në diskutimin për projektligjin "Për eksperimentimin e transmetimeve numerike në territorin e Republikës së Shqipërisë";

JANAR 2005
DEPARTAMENTI JURIDIK DHE I LICENCAVE
DEPARTAMENTI TEKNIK

- b. Përgatitja, bazuar në dispozitat e projektligjit "Për eksperimentimin e transmetimeve numerike në territorin e Republikës së Shqipërisë" në përputhje me parimet e ligjit "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", e kritereve dhe kushteve për organizimin e konkurrimit të kandidaturave për t'u shpallur operatorë për eksperimentimin e transmetimeve numerike;

SHKURT 2005

DEPARTAMENTI JURIDIK DHE I LICENCAVE
DEPARTAMENTI TEKNIK
DEPARTAMENTI I PROGRAMEVE
DEPARTAMENTI EKONOMIK
DREJTORIA E PERSONELIT

- c. Përgatitja e specifikimeve teknike për rrjetet numerike tokësore që do të eksperimentohen, përfshirë caktimin e radiofrekuencave dhe zonën përkatëse të mbulimit;

MARS 2005
DEPARTAMENTI TEKNIK

- d. Miratimi i kritereve dhe kushteve nga Këshilli dhe shpallja e konkurrimit të kandidaturave për rrjetet numerike tokësore;

MARS 2005
DEPARTAMENTI JURIDIK DHE I LICENCAVE

- e. Organizimi i konkurrimit, për operatorë eksperimentalë rrjeti numerik tokësor, shpallja e fituesve dhe botimi në “Gazetën Zyrtare”;

MARS 2005
DEPARTAMENTI JURIDIK DHE I LICENCAVE
DEPARTAMENTI TEKNIK

- f. Identifikimi i operatorëve vendorë e kombëtarë që të transmetojnë në rrugë satelitore dhe njoftimi zyrtar për paraqitjen e aplikimit në përputhje me ligjin “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë” dhe rregulloren “Për transmetimet e programeve radiotelevizive tokësore me satelit dhe anasjelltas”;

JANAR 2005
DEPARTAMENTI JURIDIK DHE I LICENCAVE
DEPARTAMENTI TEKNIK

- g. Shqyrtimi i aplikimeve nga Komisioni i Vlerësimit dhe paraqitja për miratim pranë Këshillit;

MARS 2005
DEPARTAMENTI JURIDIK DHE I LICENCAVE

h. Miratimi i Lejeve nga Këshilli;

DEPARTAMENTI TEKNIK
DEPARTAMENTI I PROGRAMEVE
DEPARTAMENTI EKONOMIK

i. Marrja e masave për mbylljen e transmetimeve satelitore nga subjekte që eventualisht nuk do të aplikojnë për Leje për transmetime satelitore;

MARS 2005
DEPARTAMENTI JURIDIK DHE I LICENCAVE

MARS 2005
DEPARTAMENTI JURIDIK DHE I LICENCAVE
DEPARTAMENTI TEKNIK

2. Legalizimi i transmetimeve të operatorëve vendorë të mbështetur në rrjete analoge tokësore që kanë instaluar impiante transmetimi jashtë zonës së licencimit

a. Ripërsëritja e propozimit për amendimin e ligjit në favor të kufizimit të zonës së licencimit të operatorëve vendorë dhe të krijimit të operatorëve rajonalë me zonë mbulimi më shumë se katër qarqe;

JANAR 2005
DEPARTAMENTI JURIDIK DHE I LICENCAVE
DEPARTAMENTI TEKNIK
DEPARTAMENTI I PROGRAMEVE
DEPARTAMENTI EKONOMIK
DREJTORIA E PERSONELIT

b. Përpunimi i kritereve të rilicencimit të operatorëve vendorë radio e televizivë, me synim përfshirjen e klauzolave detyruese për respektimin e zonës së caktuar të licencimit dhe zbatimin e planit të migrimit;

SHKURT 2005
DEPARTAMENTI JURIDIK DHE I LICENCAVE
DEPARTAMENTI TEKNIK

DEPARTAMENTI I PROGRAMEVE
DEPARTAMENTI EKONOMIK
DREJTORIA E PERSONELIT

- c. Llogaritja e evidentimi për secilin subjekt të licencuar si operator vendor, i detyrimeve për licencë dhe taksat për frekuencat për zonat e mbuluara pa autorizimin e KKRT, jashtë zonës së tij të licencimit;

SHKURT 2005
DEPARTAMENTI EKONOMIK
DEPARTAMENTI TEKNIK

3. **Përgatitja e dokumentacionit për operatorët privatë radio e televizivë rajonalë**

- a. Studimi gjeografik, ekonomik, demografik për përcaktimin e rajoneve të Shqipërisë, ku do të shtrihet veprimtaria e TV rajonale;

MARS 2005
DEPARTAMENTI JURIDIK DHE I LICENCAVE
DEPARTAMENTI TEKNIK
DEPARTAMENTI EKONOMIK
DEPARTAMENTI I PROGRAMEVE

- b. Paraqitja e studimit pr vlersim e mendim pran operatorve, institucioneve shtetërore e organizmave kombëtare e ndërkombëtare të interesuara;

PRILL 2005
DEPARTAMENTI JURIDIK DHE I LICENCAVE

- c. Studimi i vërejtjeve e sugjerimeve dhe reflektimi në materialin përfundimtar që do të miratohet nga Këshilli Kombëtar;

PRILL 2005
DEPARTAMENTI JURIDIK DHE I LICENCAVE
DEPARTAMENTI TEKNIK
DEPARTAMENTI EKONOMIK
DEPARTAMENTI I PROGRAMEVE

d. Paraqitja e materialit në Komisionin Parlamentar të Mjeteve të Informimit Publik;

MAJ 2005
DEPARTAMENTI JURIDIK DHE I LICENCAVE

e. Përgatitja e kushteve për licencat rajonale dhe njohja e operatorëve me këto kushte nëpërmjet publikimit të tyre;

MAJ 2005
DEPARTAMENTI JURIDIK DHE I LICENCAVE
DEPARTAMENTI EKONOMIK
DEPARTAMENTI TEKNIK
DEPARTAMENTI I PROGRAMEVE

f. Përcaktimi i rajoneve, llogaritja e kapaciteve dhe përgatitja e planeve të frekuencave për operatorët rajonalë në secilin rajon;

MAJ 2005
DEPARTAMENTI TEKNIK

g. Përcaktimi i detyrimeve për licencë dhe pagesave për taksat e operatorëve rajonalë dhe miratimi i tyre në Këshill;

MAJ 2005
DEPARTAMENTI EKONOMIK
DEPARTAMENTI TEKNIK

h. Shpallja e konkurrimit të kandidaturave për operatorë rajonalë mbështetur në teknologjinë e transmetimeve analoge tokësore;

QERSHOR 2005
DEPARTAMENTI JURIDIK DHE I LICENCAVE
DEPARTAMENTI TEKNIK

i. Organizimi i konkurrimit, shpallja e fituesve dhe botimi në "Gazeten Zyrtare";

GUSHT 2005
DEPARTAMENTI JURIDIK DHE I LICENCAVE

4. Zbatimi i detyrave të shtruara nga rezolutat e Konferencës Rjonale të Radiokomunikacioneve (RRC-04), Gjenevë, Maj 2004 "Për planifikimin e transmetimeve tokësore në brezat VHF/UHF për Rajonin 1

- a. Futja në veprim e Grupit Teknik të punës për hartimin e planit të frekuencave numerike;

MARS 2005
DEPARTAMENTI EKONOMIK
DEPARTAMENTI TEKNIK
DREJTORIA E PERSONELIT

- b. Organizimi i instruktimit e trainimit të anëtarëve të grupit të punës, në bashkëpunim të ngushtë me BR, ERO, etj;

MARS 2005
DEPARTAMENTI EKONOMIK
DEPARTAMENTI TEKNIK
DRJTORIA E PERSONELIT

- c. Hartimi i planit të veprimit për organizimin e takimeve me administratat me vendet fjinje për këmbim eksperience, koordinimin e frekuencave, siç rekomandohet;

MARS 2005
DEPARTAMENTI TEKNIK
DEPARTAMENTI EKONOMIK

- d. Sigurimi i pjesëmarrjes së përfaqësuesve të KKRT, sipas afateve dhe në përputhje me Aneksin 2 të Rezolutës [COM5/1]), të RRC –04 në takimet që do të organizohen në periudhën intersesionale të RRC-04 (IPG, RPG, Workshope, etj) për azhornimin me progresin e realizuar në përgatitjet për sesionin e dytë të Radio Konferencës që do të mbahet në 2006, për hartimin e planit të frekuencave dhe për revizionimin e marrëveshjeve të Stokholmit '61 dhe të Gjenevës '89;

MARS 2005
DEPARTAMENTI TEKNIK
DEPARTAMENTI EKONOMIK
DRJTORIA E PERSONELIT

- e. Vendorsja e kontakteve institucionale me Grupin Drejtues të IPG dhe BR (Gjenevë) për të koordinuar asistencën për hartimin e planit kombëtar të frekuencave numerike bazuar në Rezolutën [COM5/1] te RRC-04;

MARS 2005
DEPARTAMENTI TEKNIK

- f. Përcaktimi i pikës së kontaktit të KKRT me Grupin Drejtues të IPG dhe BR (Gjenevë) për koordinimin e veprimeve për hartimin e planit të frekuencave për transmetime numerike tokësore në zbatim të Rezolutës [COM5/1];

MARS 2005
DEPARTAMENTI TEKNIK

- g. Përgatitja e informacionit, pas çdo aktiviteti në kuadrin e përgatitjeve për sesionin e dytë të RRC, (RRC-06), për Ministrinë e Jashtme, Ministrinë e Transporteve dhe institucione të tjera të shtetit, të interesuara mbi securinë e planifikimit të frekuencave dhe përgatitjeve për revizioninmin e marrëveshjeve të St '61 dhe Gje '89;

MARS 2005
DEPARTAMENTI TEKNIK

5. Forcimi i autoritetit, pavaresisë dhe rritja e efektivitetit të KKRT

- a. Adoptimi i Kodit të Sjelljes për anëtarët e Këshillit dhe punonjësit e administratës, bazuar në aktet nënligjore të organeve rregullatore audiovizuale të disa vendeve të Europës (Francë, Itali, Belgjikë);

- b. Rishikimi i Rregullores së Brendshme të Administratës së KKRT, si dhe i rregulloreve të tjera të miratuara nga KKRT, të cilat në kuadrin e ndryshimeve që ka pësuar dhe po pëson ligji, por edhe duke parë problemet dhe detyrat që kanë dalë që nga koha e miratimit të tyre, kërkojnë përmirësim;
- c. Hartimi i planit të shkëputjes graduale nga financimet prej buxhetit të shtetit;
- d. Forcimi i lidhjeve institucionale me dikastere e institucione të tjera rregullatore për koordinimin e veprimtarisë me qëllim rritjen e efektivitetit:
 - Nënshkrimi me ERT i marrëveshjeve mbi procedurat për dhënien e:
 - a. lejeve për përdorimin e frekuencave për shërbimet pikë me pikë të operatorëve radio e televizivë të licencuar si operatorë rrjetesh tokësore analogjike apo numerike,
 - b. lejeve për përdorimin e “up-linkë”-ut satelitor nga operatorët e licencuar si operatorë të transmetimeve satelitore,
 - c. lejeve paraprake dhe përfundimtare për shtrirjen e rrjeteve të operatorëve të licencuar për transmetime me anë të kabllove,
 - Stabilizimi i procedurave me policinë tatimore, që është e ngarkuar me ligj të zbatojë vendimet e KKRT,
 - Informimi i Komisionit Parlamentar të Mjeteve të Informacionit Publik për gjendjen dhe pasqyrimi i çështjeve ku kërcohët kontributi i tij,
 - Pjesëmarrje në diskutimet për përshtatjen e Planit Kombëtar të Frekuencave, që miratohet nga Këshilli i Ministrave.
- e. Forcimi i marrëdhënieve me RTSH, operatorin e vetëm publik, lidhur me përcaktimin e strategjisë së tij të zhvillimit;

6. Riororganizim për rritjen e efektivitetit të monitorimit të programeve informative të operatorëve radiotelevizivë kombëtarë

- a. Përcaktimi i metodologjisë së monitorimit, duke u nisur nga përvoja e deritanishme;

**SHKURT-DHJETOR 2005
DEPARTAMENTI I PROGRAMEVE**

- b. Gjetja e një moduli të përshtatashëm e më të thjeshtë për t'u konceptuar nga vetë operatorët rtv e institucionet e interesuara;

**SHKURT-DHJETOR 2005
DEPARTAMENTI I PROGRAMEVE**

- c. Përcaktimi i subjekteve rtv të monitoruara, duke shtuar detyrimisht edhe Radio +2, të lënë jashtë monitorimit në periudhën e deritanishme;
- SHKURT-DHJETOR 2005
DEPARTAMENTI I PROGRAMEVE**
- d. Përcaktimi i hapësirave informative që do të monitorohen. Vend që do të zënë në monitorim edicionet qendrore të lajmeve dhe rubrikat e aktualitetit në radio dhe televizion;
- SHKURT-DHJETOR 2005
DEPARTAMENTI I PROGRAMEVE**
- e. Rishikimi i mundësive për të zgjeruar studimin mbi qëndrimin e operatorëve të ndryshëm për të njëtin lajm, të transmetuar ose jo, në edicionet e lajmeve;
- SHKURT-DHJETOR 2005
DEPARTAMENTI I PROGRAMEVE**
- f. Paraqitja në Këshill dhe Miratimi;
- SHKURT-DHJETOR 2005
DEPARTAMENTI I PROGRAMEVE**

7. Monitorimi i programeve informative të operatorëve radiotelevizivë kombëtarë

- a. Publikimi i rezultateve të monitorimit dhe dukurive që spikasin, në zbatimin ose jo të parimeve të përgjithshme të vërtetësisë, pavarësisë dhe paanshmërisë në programet informative;

**SHKURT-DHJETOR 2005
DEPARTAMENTI I PROGRAMEVE**

8. Monitorimi i Fushatës Zgjedhore 2005

- a. Hartimi i "Kujtesës" për të gjithë operatorët radiotelevizivë me kërkesat për zbatimin e Ligjit "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë" dhe Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë;

**MAJ-QERSHOR 2005
DEPARTAMENTI I PROGRAMEVE**

- b. Publikimi dhe njohja me Kujtesën për të gjithë operatorët radiotelevizivë, subjektet politike pjesëmarrëse në zgjedhje, institucionet e interesuara si OSBE-ODHIR etj;

**MAJ-QERSHOR 2005
DEPARTAMENTI I PROGRAMEVE**

- c. Hartimi i marrëveshjes së përbashkët me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, për mbarëvajtjen e procesit të pasqyrimit të Fushatës Zgjedhore nga media elektronike. Miratimi nga KKRT;

**MAJ-QERSHOR 2005
DEPARTAMENTI I PROGRAMEVE**

- d. Hartimi dhe Miratimi i projektit të monitorimit, ku të përfshihen metodikat, subjektet e monitoruara, forma e publikimit të rezultateve, mënyra e financimit, ndarja e kompetencave midis KKRT dhe Bordit të Monitorimit, etj;

e.

**MAJ-QERSHOR 2005
DEPARTAMENTI I PROGRAMEVE**

- f. Trajnim i Grupit të Monitoruesve dhe përpunuesve të të dhënave;

**MAJ-QERSHOR 2005
DEPARTAMENTI I PROGRAMEVE
DEPARTAMENTI I PERSONELIT**

9. Organizimi i investigimit mbi marrëdhëni kontraktuale të operatorëve RTV me distributorët e krijimtarisë RTV

- a. Verifikimi i numrit dhe statusit të agjencive distributore të krijimtarisë radiotelevizive në Shqipëri

QERSHOR 2005
DEPARTAMENTI JURIDIK DHE I LICENCAVE
DEPARTAMENTI EKONOMIK

- b. Verifikimi i kontratave të nënshkruara midis operatorëve rtv dhe agjencive distributore dhe mënyrës së likuidimit.

GUSHT 2005
DEPARTAMENTI JURIDIK DHE I LICENCAVE
DEPARTAMENTI EKONOMIK

- c. Evidentimi i pronarëve të medias elektronike në Shqipëri dhe verifikimi i përputhjes së statusit të tyre me ligjin “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë” përsa i takon numrit të licencave në emër të tyre ose të afërmve.

GUSHT 2005
DEPARTAMENTI JURIDIK DHE I LICENCAVE

10. Monitorimi i transmetimit të reklamave nga TV

- a. Përgatitja e projektit për monitorimin e transmetimit të reklamave nga operatorët televizivë, duke pasur parasysh këto drejtime:

- monitorimi i reklamave për disa subjekte rtv,
- argumentimi ekonomik nga pikëpamja e potencialit të tregut të transmetimeve radio e televizive;

SHKURT-MARS 2005
DEPARTAMENTI I PROGRAMeve
DEPARTAMENTI EKONOMIK

- b. Përcaktimi i subjekteve që do të monitorohen, përcaktimi i modulit të monitorimit, zgjedhja e personelit të monitorimit dhe gjetja e burimeve të financimit të monitorimit;

c. Trajnim i grupit të monitoruesve;

SHKURT-MARS 2005
DEPARTAMENTI I PROGRAMEVE
DEPARTAMENTI I PERSONELIT

d. Njohja e operatorëve me rezultatet e monitorimit;

SHKURT-MARS 2005
DEPARTAMENTI I PROGRAMEVE
DEPARTAMENTI I PERSONELIT

11. Pirateria rtv: monitorimi i programeve radiotelevizive

a. Monitorimi i programeve rtv në Studion e Monitorimit për televizionet dhe radiot, sinjali i të cilave mbërrin në selinë e KKRT. Ballafaqimi i rezultateve të monitorimit me dokumentacionin e depozituar nga secili subjekt, në zbatim të kërkesave të Ligjit Nr. 9124, datë 29.07.2003;

VAZHDIMISHT
DEPARTAMENTI I PROGRAMEVE

b. Monitorimi me sondazhe i programeve të transmetuara nga subjektet rtv nëpër rrethe, me grupe monitorimi;

VAZHDIMISHT
DEPARTAMENTI I PROGRAMEVE

c. Monitorimi i programeve të rtransmetuara nga operatorët kabllorë. Ballafaqimi me dokumentacionin e depozituar në zbatim të ligjit. Marrja e masave rregulluese të veprimtarisë së tyre;

VAZHDIMISHT
DEPARTAMENTI I PROGRAMEVE

12. Përafrimi i legjislacionit shqiptar me atë europian

- a. Do të studiohet praktika europiane e legjislacionit për median elektronike, ose më saktë, legjislacioni i disa vendeve me përafersira në trashëgiminë kulturore, sociale dhe ekonomike;

**SHKURT-DHJETOR 2005
DEPARTAMENTI I PROGRAMEVE**

- b. Do të studiohen dokumenta të rëndësishme të BE, si Direktiva e Televizionit pa Kufi etj, për të përcaktuar detyrimet përkatëse;

**SHKURT-DHJETOR 2005
DEPARTAMENTI I PROGRAMEVE**

- c. Do të hartohen në bashkëpunim me Departamentin Juridik dhe të Licencave projekt i amendamenteve të mundshme dhe të detyrueshme në përafrimin e legjislacionit;

**SHKURT-DHJETOR 2005
DEPARTAMENTI I PROGRAMEVE**

- d. Këto propozime për ndryshime në ligj do t'i paraqiten edhe shoqatave të medias elektronike për miratim dhe do t'i jepen Komisionit Parlamentar të Medias për ndjekjen e procedurave të mëtejshme;

**SHKURT-DHJETOR 2005
DEPARTAMENTI I PROGRAMEVE**

14. Rregullimet e licencimit**13. Masat për sigurimin e transparencës lidhur me pronesinë mbi mediat**

- a. Paraqitura e propozimit për ndarjen e licencimit të rrjetave nga licencimi i programeve;

**NE KUADRIN E DOK. TE STRATEGJISE
DEPARTAMENTI JURIDIK DHE I LICENCAVE
DEPARTAMENTI TEKNIK
DEPARTAMENTI I PROGRAMEVE**

b. Organizimi i spektrit te frekuencave televizive e rrjetave te pronesi te një pronari te vetem;

- b. Përcaktimit të kritereve mbi çasinë e rrjeteve në pronësi të një pronari të vetëm;

NE KUADRIN E DOK. TE STRATEGJISE
DEPARTAMENTI JURIDIK DHE I LICENCAVE
DEPARTAMENTI TEKNIK
DEPARTAMENTI EKONOMIK

- c. Përmirësimit të kritereve për përcaktimin e "pronësisë indirekte" mbi mediat dhe përgatitja e propozimit përkatës për amandin e ligjit "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë";

NE KUADRIN E DOK. TE STRATEGJISE
DEPARTAMENTI JURIDIK DHE I LICENCAVE
DEPARTAMENTI TEKNIK
DEPARTAMENTI EKONOMIK

- d. Ndjekja në Regjistrin Tregtar e ndryshimeve të mundshme të të dhënavë të paraqitura në kërkesën për marrjen e licencës së operatorëve rtv në përputhje me kërkesat e ligjit;

VAZHDIMISHT
DEPARTAMENTI JURIDIK DHE I LICENCAVE

14. Riorganizimi i spektrit të frekuencave televizive të rajonit të Tiranës (Zbatimi i pjesshëm i Planit të Migrimit)

- a. Përcaktimi i operatorëve vendorë e kombëtarë që do të transmetojnë deri në fund të vitit 2005 (fundi i periudhës së licencimit për operatorët lokalë TV) nga mali i Dajtit;

JANAR 2005
DEPARTAMENTI JURIDIK DHE I LICENCAVE
DEPARTAMENTI TEKNIK

- b. Organizimi i diskutimit teknik me secilin operator dhe fiksimi i karakteristikave individuale të transmetimit të pajisjeve transmetuese që do të përdoren pas rilicencimit, që do të realizohet nëse operatori do t'i plotësojë kushtet;

MARS 2005
DEPARTAMENTI JURIDIK DHE I LICENCAVE
DEPARTAMENTI TEKNIK

- c. Kontaktimi me të gjithë operatorët e rajonit të Tiranës dhe rajonet të cilat preken nga ndryshimi i frekuencave të transmetuesve në malin e Dajtit, mbi masat për organizimin e kalimit në frekuencat e caktuara nga Plani i Migrimit. Caktimi i frekuencave që do të ndryshojnë në rajonet fqinje me Tiranën dhe informimi i operatorëve që preken, për ndryshimet që do të bëhen njëkohësisht me ndryshimin e frekuencave të rajonit të Tiranës;

PRILL- MAJ 2005
DEPARTAMENTI JURIDIK DHE I LICENCAVE
DEPARTAMENTI TEKNIK

- d. Caktimi i afatit të kalimit dhe njoftimi i operatorëve të rajoneve përrreth Tiranës mbi interferencat që mund të ndodhin përkohësisht pas kalimit të operatorëve të Tiranës në frekuencat definitive;

QERSHOR-KORRIK 2005
DEPARTAMENTI JURIDIK DHE I LICENCAVE
DEPARTAMENTI TEKNIK

- e. Realizimi i kalimit dhe evidentimi i ndryshimit të gjendjes;

DHJETOR 2005
DEPARTAMENTI JURIDIK DHE I LICENCAVE
DEPARTAMENTI TEKNIK

15. Miratimi në Këshill i anullimit të Procedurve për licencimin e operatorit të tretë privat kombëtar televiziv mbështetur në teknologjinë e transmetimeve tokësore dhe publikimi i vendimit përkatës

SHKURT 2005
KKRT

DEPARTAMENTI TEKNIK

16. Evidentimi i gjendjes së transmetimeve radio e televizive në fund të vitit 2004

- a. Organizimi i marrjes së informacionit nga operatorët për zbatimin e detyrave përmblimin e zonës së licencimit për vitin 2003;

JANAR 2005**DEPARTAMENTI JURIDIK DHE I LICENCAVE**

- b. Verifikimi i të dhënave;

MARS 2005**DEPARTAMENTI JURIDIK DHE I LICENCAVE****DEPARTAMENTI TEKNIK****DEPARTAMENTI EKONOMIK****DEPARTAMENTI I PROGRAMEVE**

- c. Raportimi në Këshill mbi gjendjen;

PRILL 2005**DEPARTAMENTI JURIDIK DHE I LICENCAVE****DEPARTAMENTI EKONOMIK****DEPARTAMENTI I PROGRAMEVE**

- a. Paraqitja e materialit në Komisionin Parlamentar të Mjeteve të Informimit Publik;

MAJ 2005**DEPARTAMENTI JURIDIK DHE I LICENCAVE****17. Puna me operatorët**

- a. Udhëzim për identifikimin e pajisjeve transmetuese në të gjitha pikat transmetuese, si dhe përcaktimi i detyrimeve për strehuesit e pajisjeve transmetuese, për të parandaluar transmetimet e palicencuara;

PRILL 2005

DEPARTAMENTI TEKNIK
DEPARTAMENTI JURIDIK DHE I LICENCAVE

- b. Organizimi i punës për plotësimin e dokumentacionit të frekuencave në dispozicion të operatorëve, nëpërmjet dhënies së lejeve të përdorimit të frekuencave dhe targetave identifikuase që do t'u ngjiten pajisjeve transmetuese;

MAJ – GUSHT 2004
DEPARTAMENTI TEKNIK

- c. Ndërmarrja e sanksioneve administrative, si dhe propozim për masa të mëtejshme të KKRT për shkelje të dispositave të ligjit, kushteve të licencës dhe rregulloreve të miratuar nga KKRT ndaj subjekteve të ndryshme kundravajtëse, të licensuara ose jo, mbi bazën e inspektimeve të kryera nga inspektorët;

VAZHDIMISHT
DEPARTAMENTI JURIDIK DHE I LICENCAVE

- d. Mbajtja e kontakteve të vazhdueshme me organet tatumore, të ngarkuara nga ligji për të mbështetur KKRT në ushtrimin e të drejtave që burojnë nga ligji;

VAZHDIMISHT
DEPARTAMENTI JURIDIK DHE I LICENCAVE

- e. Trajtimi dhe ndjekja me seriozitet e çështjeve gjyqësore, duke kërkuar, në rastet kur do të shihet e nevojshme, edhe ndihmën e departamenteve të tjera të Administratës së KKRT;

VAZHDIMISHT
DEPARTAMENTI JURIDIK DHE I LICENCAVE

18. Shqyrtimi në mënyrë periodike i letrave të interesit për dhënie frekuencash që do të paraqiten në KKRT, dhe shpallja në mënyrë publike, mbi bazën e mundësive teknike të realizimit të kërkesave, për organizimin e konkurrimit të kandidaturave për zonat ku ekzistojnë mundësitë teknike

- a. Drejtimi i punës së Komisionit të Shqyrtimit të Dokumentacionit për shqyrtimin e aplikimeve që do të paraqiten nga subjektet e interesuara, duke përgatitur Relacionet e Vlerësimit;

**VAZHDIMISHT
DEPARTAMENTI JURIDIK DHE I LICENCAVE**

- b. Paraqitja e këtyre relacioneve, si dhe e projektvendimeve përkatëse për miratim KKRT-së;

**VAZHDIMISHT
DEPARTAMENTI JURIDIK DHE I LICENCAVE**

19. Përfundimi i procesit të rinoimit të licencave për disa operatorë rtv, të cilëve u ka përfunduar afati i licensimit, si dhe të atyre që pritet t'u përfundojë në muajt në vazhdim

- a. Pasqyrimi dhe vlerësimi i sjelljes së operatorëve gjatë periudhës së licensimit;

**MAJ 2005
DEPARTAMENTI JURIDIK DHE I LICENCAVE
DEPARTAMENTI I PROGRAMEVE
DEPARTAMENTI TEKNIK
DEPARTAMENTI EKONOMIK
DREJTORIA E PERSONELIT**

- b. Shpallja e listës së operatorëve të cilëve u përfundon afati i licencës gjatë viti 2005 dhe e kritereve që do të ndiqen gjatë procesit të rinoimit të licencave, sipas frekuencave dhe zonave përkatëse të mbulimit;

**MAJ 2005
DEPARTAMENTI JURIDIK DHE I LICENCAVE**

- c. Organizimi i shqyrtimit të dokumentacionit të aplikimit për rinoim licence;

**SHTATOR 2005
DEPARTAMENTI JURIDIK DHE I LICENCAVE
DEPARTAMENTI I PROGRAMEVE
DEPARTAMENTI TEKNIK**

DEPARTAMENTI EKONOMIK
DREJTORIA E PERSONELIT

- d. Drejtimi i punës së Komisionit të Shqyrtimit të Dokumentacionit për shqyrtimin e aplikimeve që do të paraqiten nga subjektet e interesuarë, duke përgatitur Relacionet e Vlerësimit;

TETOR 2005
DEPARTAMENTI JURIDIK DHE I LICENCAVE
DEPARTAMENTI I PROGRAMEVE
DEPARTAMENTI TEKNIK
DEPARTAMENTI EKONOMIK
DREJTORIA E PERSONELIT

- e. Paraqjeta e relacioneve për rinvim licence, si dhe e projektvendimeve përkatëse për miratim para KKRT-së;

NENTOR 2004
DEPARTAMENTI JURIDIK DHE I LICENCAVE
DEPARTAMENTI I PROGRAMEVE
DEPARTAMENTI TEKNIK
DEPARTAMENTI EKONOMIK
DREJTORIA E PERSONELIT

- f. Botimi në Fletoren Zyrtare;

NENTOR 2004
DEPARTAMENTI JURIDIK DHE I LICENCAVE
DEPARTAMENTI I PROGRAMEVE
DEPARTAMENTI TEKNIK
DEPARTAMENTI EKONOMIK
DREJTORIA E PERSONELIT

20. Trajtimi i problemeve të zbatimit të rregullave të Etikës

- a. Monitorimi i programeve të ankimuara;

VAZHDIMISHT

h. Studimi i etikës

KESHILLI I ANKESAVE

- b. Kontaktet me mediat e ankimuara për rastet e gjykuara për mosrespektim të nirmave etiko-morale;

i. Përvjetori i etikës

**VAZHDIMISHT
KESHILLI I ANKESAVE**

- c. Sensibilizimi në mënyrë të vazhdueshme të opinionit publik për përgjegjësinë e operatorëve në respektimin e normave etike e morale;

j. Konkluzioni i etikës

**VAZHDIMISHT
KESHILLI I ANKESAVE**

- d. Përpunimi kompjuterik i të dhënavë të Anketës Vjetore 2004;

k. Konkluzioni i etikës

**JANAR-MARS 2005
KESHILLI I ANKESAVE**

- e. Konklusionet e anketës dhe publikimi i tyre elektronike dhe të shkruar;

l. Përgatitja e etikës

**JANAR-MARS 2005
KESHILLI I ANKESAVE**

- f. Përgatitja dhe botimi i buletinit "Antena 9";

m. Studimi i etikës

**JANAR-MARS 2005
KESHILLI I ANKESAVE**

- g. Studimi për domosdoshmërinë dhe implementimin e Bordeve të Etikës në median publike dhe private;

n. Përgatitja e etikës

**PRILL-QERSHOR 2005
KESHILLI I ANKESAVE**

h. Studimi për domosdoshmërinë dhe implementimin e Kodeve të Etikës në median publike dhe private;

**PRILL-QERSHOR 2005
KESHILLI I ANKESAVE**

i. Përvoja e huaj për Bordet e Etikës dhe Kodet e Etikës;

**PRILL-QERSHOR 2005
KESHILLI I ANKESAVE**

j. Konkluzione për keqpërdorimin e dhunës në emisionet e lajmeve;

**KORRIK-SHTATOR 2005
KESHILLI I ANKESAVE**

k. Konkluzione për keqpërdorimin e seksit në filmat që shfaqen brenda orës kufi;

**KORRIK-SHTATOR 2005
KESHILLI I ANKESAVE**

l. Përgatitja dhe botimi i buletinit “Antena 10”;

**KORRIK-SHTATOR 2005
KESHILLI I ANKESAVE**

DETYRA TE POLITIKES E STRATEGJISE

1. Përpunimi dhe miratimi i strategjisë e politikës së zhvillimit dhe planit kombëtar të frekuencave për brezat RTV

- a. Bazuar në vërejtjet e Këshillit të Europës, OSBE, ERT, etj., të ripunohet materiali i Strategjisë së Zhvillimit të Transmetimeve Radiotelevizive Numerike në Shqipëri. Për çështjet që gjykojnë të pazbatueshme në kushtet e Republikës së Shqipërisë, të përgatiten argumentimet përkatëse;

SHKURT 2005
KKRT

- b. Organizimi i térheqjes së informacionit, mendimeve dhe kontributit të institucioneve, organeve të interesuara të vendit dhe operatorëve, mbi drejtimet e rrugët e zhvillimit të transmetimeve radio e televizive numerike tokësore dhe përpunimit të planit të frekuencave numerike, nëpërmjet mbajtjes së Tryezës së Rrumbullakët;

MARS 2005
KKRT

- c. Térheqja e mendimit dhe ekspertizës së organizmave homologe ndërkombëtare dhe institucioneve të specializuara kombëtare e ndërkombëtare për rekomandimet, direktivat, eksperiencat e vendeve të tjera në fushën e futjes së transmetimeve numerike tokësore dhe ftesa për pjesëmarrjen e tyre në diskutimet rreth Tryezës së Rrumbullakët;

SHKKURT-MARS 2005
KKRT

- d. Organizimi i konsultimeve me operatorët për domosdoshmërinë dhe mënyrat e hartimit të politikës së zhvillimit dhe planit kombëtar të frekuencave radio e televizive, si dhe për ruajtjen e parametrave të fiksuar në plan, për të garantuar vazhdueshmërinë e cilësinë e shërbimit;

PRILL-MAJ 2005
DEPARTAMENTI JURIDIK DHE I LICENCAVE
DEPARTAMENTI TEKNIK
DEPARTAMENTI I PROGRAMEVE
DEPARTAMENTI EKONOMIK

- e. Hartimi i konkluzioneve paraprake të dokumentit të Strategjisë e amendimeve të nevojshme të ligjit “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë” dhe paraqitja përmendim Komisionit Parlamentar të Mjeteve të Informimit Publik e institucioneve dhe organizmave të tjera të interesuara;

SHTATOR 2004

DEPARTAMENTI JURIDIK DHE I LICENCAVE
DEPARTAMENTI TEKNIK
DEPARTAMENTI I PROGRAMEVE
DEPARTAMENTI EKONOMIK

- f. Shqyrtimi i vërejtjeve dhe përgatitja e konkluzioneve përfundimtare;

SHTATOR-TETOR 2004

DEPARTAMENTI JURIDIK DHE I LICENCAVE
DEPARTAMENTI I PROGRAMEVE
DEPARTAMENTI TEKNIK
DEPARTAMENTI EKONOMIK
DREJTORIA E PERSONELIT

2. Bazuar në politikën e zhvillimit të transmetimeve radio e televizive, të përgatiten propozimet për amendime të bazës ligjore

- a. Përmirësimi i akteve ligjore në fushën e programeve;
- b. Përmirësimi i akteve ligjore në fushën teknike dhe të administrimit të frekuencave;
- c. Përmirësimi i akteve ligjore në lidhje me sigurimin e të ardhurave financiare, përrritjen e burimeve të financimit për zhvillimin normal të aktivitetit të institucionit;

TETOR 2004

DEPARTAMENTI JURIDIK DHE I LICENCAVE
DEPARTAMENTI I PROGRAMEVE
DEPARTAMENTI TEKNIK
DEPARTAMENTI EKONOMIK
DREJTORIA E PERSONELIT

MONITORIMI I FREKUENCAVE

1. Kontrolli periodik i okupimit të brezave të frekuencave për transmetime radio e televizive në të gjithë territorin e vendit;

MAJ-DHJETOR 2005
DEPARTAMENTI TEKNIK

2. Kontrolli periodik i cilësisë së sinjaleve të emetuar nga operatorët radio e televizivë në të gjithë territorin e vendit;

MAJ, DHJETOR 2005
DEPARTAMENTI TEKNIK

3. Azhornimi i regjistrat të stacioneve dhe dokumentacionit të raportimeve të monitorimit;

QERSHOR 2005
DEPARTAMENTI TEKNIK

4. Identifikimi dhe lokalizimi i transmetimeve radio e televizive të paautorizuara;

VAZHDIMISHT
DEPARTAMENTI TEKNIK

5. Identifikimi e lokalizimi i interferencave në sinjalet e transmetuara nga operatorët radio e televizivë;

VAZHDIMISHT
DEPARTAMENTI TEKNIK

6. Koordinimi me organet rregullatore të vendeve fqinje, për mbrojtjen nga interferencat e stacioneve të huaja, në zbatim të Planit Ndërkombëtar të Frekuencave;

VAZHDIMISHT
DEPARTAMENTI TEKNIK

7. Rekrutimi i stafit të ri (planifikimi i frekuencave dhe inxhineria, kompetencat legale);

**DREJTORIA E PERSONELIT
DEPARTAMENTI TEKNIK**

Aneks 1

REALIZIMI I BUXHETIT PER VITIN 2004, DETYRIMET FINANCIARE TE OPERATOREVE RADIOTELEVIZIVE

Për vitin 2004, buxheti në zerin “Shpenzime operative” dhe “Investime” për Këshillin Kombëtar të Radios dhe Televizionit, nga 72 milionë lekë është realizuar 34 milionë e 132 mijë lekë, ose 47.4 përqind.

10.1. Realizimi i fondeve të buxhetit

Për vitin 2004, buxheti në zerin “Shpenzime operative” dhe “Investime” për Këshillin Kombëtar të Radios dhe Televizionit, nga 72 milionë lekë të planifikuara, është realizuar 34 milionë e 132 mijë lekë, ose në përqindje 47.4, në shumë absolute me një mosrealizim prej 37 milionë e 900 mijë lekë.

Realizimi i shpenzimeve, sipas strukturës, paraqitet si më poshtë:
Në milionë lekë

Struktura e shpenzimeve	Plan	Fakt	Dif.	%
Shpenzime operative	34	34	-	100
Investime	38	0.13	37.9	0.34
Gjithsej	72	34.13	37.9	47.4

• Realizimi i fondeve në zerin “Shpenzime operative”

Plani i shpenzimeve, në masën prej 34 milionë lekë i detajuar në zëra për vitin 2004, u realizua në masën 100 përqind, zë për zë, si më poshtë:

Në milionë lekë

Shpenzimet	Plani	Fakti	Diferenca	%
1.Pagat e shpërbllimet e anëtarëve të KKRT-së	23	23	0	100
2.Sigurimet shoqërore	4.5	4.5	0	100
3.Shpenzime të ndryshme	6.5	6.6	0	
Gjithsej	34	34		100

Realizimi i fondeve në zerin Investime

Plani i investimeve për vitin 2004, nga 38 milionë lekë të planifikuara, u realizua 132 mijë lekë, me një mosrealizim në shume absolute për 37.8 milionë lekë, ose rreth 0.34 përqind.

Realizimi i investimeve në strukturë paraqitet si më poshtë;
Në milionë lekë

Emërtimi	Plan	Fakti	%
• Përpunimi i planit kombëtar të Frekuencave	8	-	
• Rikonstruksion	12	-	
• Strategji e zhvillimit të transmetimeve televizive	15	-	
• Blerje pajisje operacionale	3	0.132	9.4
Shuma	38	0.132	0.34

Valuta jo tregtare

Në mbështetje të urdhreve përkatëse të dala për këtë qëllim, gjatë vitit 2004, institucioni ynë ka përdorur rreth 15682 Euro, të detajuar si më poshtë:

	Euro
Shpenzim për udhëtim e dieta	13500
Shpenzime për pagesë kuotizacioni EPRA	1864
Shpenzime zyre	318
Gjithsej	15682

Për kundravleftën në leke të valutës, janë përdorur fonde buxhetore dhe të ardhurat e institucionit.

Të ardhurat

Krahas fondevë buxhetore, KKRT ka realizuar të ardhura të cilat janë depozituar në llogarinë tonë në bankë.

Të ardhurat e realizuara kanë qenë pagesat vjetore të licencave, që subjektet kanë bërë dhe pagesat për marrjen e licencës. Të ardhurat e trashëguara dhe të realizuara për vitin 2004 deri në ditën e sotme, 25.01.2005, janë 97.4 milionë lekë fonde në dispozicion të institucionit tonë. Gjatë vitit 2004, për të përballuar shpenzimet e administratës janë përdorur të ardhura në shumën prej 7 milionë lekë, nga të cilat, për shpenzime operative janë përdorur 5.5 milionë lekë dhe investime, për blerje pajisje zyre, etj, 1.5 milionë lekë.

Sic dihet, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizonit, për vitin 2005, është përjashtuar nga skema e financimit të buxhetit të shtetit. Në përpjekje për sigurimin e

pavarësisë së institucionit, KKRT-ja ka planifikuar shkëputjen graduale të buxhetit të saj nga buxheti i shtetit, sipas një skeme, realizimi i së cilës përfundon në vitin 2008. Ky plan është futur edhe në matricën e planit të veprimeve për zbatimin e rekomandimeve të partneritetit evropian (PVZRPE), që koordinohet nga Ministria e Bashkëpunimit Ekonomik. Shkëputja e parakohshme nga buxheti i shtetit, krijon vështirësi suplementare për KKRT-në, që është e detyruar të kërkojë burime e fonde për stabilizimin e ambienteve të punës. (Siç dihet, godina ku KKRT ushtron aktivitetin, është pronë e Drejtorisë së Përgjithshme të Daganave).

Përpunimi i planit kombëtar të frekuencave

Siç është raportuar në vitin 2003, KKRT ka miratuar kriteret e hartimit të planit të frekuencave, si dhe çeljen e garës për përcaktimin e firmës konsultuese. U përgatit gjithashtu edhe projekt i kërkesës për shfaqjen e interesit për të marrë pjesë në garën për përcaktimin e konsulentit.

Gara për përcaktimin e firmës konsultuese nuk u krye, për shkak të zhvillimeve të shpejta e të papritura, me të cilat u perballën qysh në fillim të vitit, si rezultat i daljes në trasmetim të “Digitalb-it”.

Futja e transmetimeve numerike e komplikon planin e frekuencave. KKRT u detyrua të përgatisë me resurset e veta, një dokument që do të shërbente si bazë për fillimin e diskutimeve me të gjitha palët e interesuara, brenda e jashtë vendit. Dokumenti u dërgua për konsulencë dhe pranë OSBE-së dhe Këshillit të Europës, të cilët bënë vërejtjet e tyre. Ndërkohë, organizimi i Tryezës së Rumbullakët për fillimin e diskutimit të çështjes së futjes së trasmetimeve numerike në Shqipëri dhe mbylljen graduale të trasmetimeve analoge, u shty për në vitin 2005, me qëllim që të lihej koha e nevojshme për reflektim nga të gjitha palët.

Konferenca e Radiokomunikacioneve RRC-04, e mbajtur në Gjenevë, në Maj 2004, përcaktoi që, në vitin 2006, do të përvijohet plani i frekuencave për rajonin tonë, që do të kërkojë ndryshimin e marrëveshjes së Stockholmit '61.

Për këtë arsy, KKRT e sheh të nevojëshme për të kaluar në vitin 2005, fondin e parashikuar në vitin 2004, për mbështetjen e hartimit të planit kombëtar të frekuencave, që kërkon domosdoshmërisht ekspertizë të specializuar.

Rikonstruksion

Realizimi i këtyre fondeve ishte i kushtëzuar me sistemimin përfundimtar të KKRT-së në ish-godinën e Hotel “Drinit”, ku aktualisht, ne kemi nën administrim katin e IV dhe të V të kësaj godine. Gjatë vitit u realizua tenderi për detyrën e projektimit të rikonstruksionit të godinës dhe më pas, duhej të fillonte rikonstruksioni, por nuk u realizuan punimet, pasi godina është në proces gjyqësor me aksionerët, të cilët e kanë blerë me letra me vlerë.

Blerje pajisje operacionale

Për vitin 2004, në këtë zë kemi pasur në dispozicion për të realizuar 3 milionë lekë, janë realizuar 132 mijë lekë, vlefta e blerjes së kameras dixhtale.

Realizimi i këtyre fondeve ka qenë lidhur me realizimin e rikonstruksionit të godinës, pra, të ambienteve ku do të instaloheshin aparaturat e planifikuara.

Dhurimet

Për vitin 2004 nuk kemi pasur donacione. Donatorë të ndryshëm si: Mbretëria e Danimarkës me projektin **Danida** dhe **IREX PRO Media** përvitet 2000-2002 na kanë financuar për **350.416 dollarë**.

10.2. Detyrimet e operatorëve radiotelevizivë

Pagesat për licencë

Pagesat për licencë vjetore për operatorët Radio FM e TV përvitin 2004, nga 38 milionë e 500 mijë lekë janë realizuar 32 milionë e 727 mijë lekë, ose 85 përqind.

Operatorët radio FM kanë realizuar pagesat për licencë në shumen prej 4 milionë e 502 mijë lekë, ose 71.6 përqind.

Operatorët TV kanë realizuar pagesat për licencë në shumën prej 28 milionë e 225 mijë lekë, ose 87.6 përqind.

Pagesat për taksa

Taksat për shërbime radiotelevizive për operatorë të trasmetimeve FM e TV, janë realizuar 7 milionë e 674 mijë lekë, nga 13 milionë e 508 mijë lekë, ose 56.8 përqind.

Operatorët FM kanë derdhur detyrimin për taksa prej 1 milionë e 673 mijë lekë nga 1 milionë e 908 mijë të planifikuar, ose 87.6 përqind.

Operatorët TV kanë derdhur detyrimin për taksa nga 11 milionë e 599 mijë lekë të planifikuar në 6 milionë lekë, ose 51.7 përqind.

Realizimi i detyrimeve të pagesave të operatorëve, si numër dhe vlefte absolute paraqitet sipas Tabelës 1, bashkangjitur materialit.

Bilancet kontabël të operatorëve rtv

Në bazë të Ligjit Nr. 8410, datë 30.09.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", neni 48, dhe të Ligjit nr. 7661, datë 19.01.1993, "Për kontabilitetin", operatorët radiotelevizivë janë të detyruar të hartojnë bilancet e tyre vjetore në përputhje me legjispcionin për kontabilitetin. Në mënyrë të veçantë duhet të pasqyrohen të dhëna për programet e trasmetuara, çmimet e tyre kur ato janë blerë, ose shuma e harxhuar kur ato janë programe origjinale, të dhëna për reklamat e trasmetuara, ose veprimitari të tjera dhe të ardhurat përkatëse, sponsorizimet, si dhe lista e financuesve apo dhuruesve me shumat përkatëse, dhe çdo shpërblim tjeter në favor të subjektit radioteleviziv.

Nga përpunimi i të dhënave sipas bilanceve të paraqitura (nga rreth 60 % e operatorëve), rezulton se treguesit e përmendur më sipër nuk janë paraqitur në mënyrë analitike, përvitësuar ide të qarta mbi bilancin ekonomik dhe burimet e financimit të operatorëve.

Në përgjithësi, operatoret e vegjël lokalë të transmetimeve radiofonike rezultojnë me fitim ose me rezultat ekonomik 0, ndërkohë që rreth 50 % e operatorëve televizivë, rezultojnë me humbje. Humbja e disa operatorëve, nga më të mëdhenjtë, kap shifra të konsiderueshme. (Humbja e TV Arbëria përvitin 2003 është 25 milionë e 364 mijë lekë,

humbja e Top Channel është 33 milionë e 205 mijë lekë, ndonëse ky i fundit nuk shlyen detyrimet për asnjë nga impiantet e instaluar jashtë zonës së licencimit. (Shih Aneksin e mbulimit).

Analiza e tregut të trasmetimeve radio e televizive

Tregu i trasmetimeve radio e televizive të Shqipërisë vazhdon të paraqitet si një treg i pazhvilluar, i pabalancuar, me deformime, që nuk siguron mbështetje të nevojshme financiare për mbijetesën e numrit të ekzagjeruar e të pajustifikuar të operatorëve, sidomos të operatorëve televizivë.

Të ardhurat

Të ardhurat kryesore të operatorëve radio e televizivë sigurohen kryesisht nga reklamat. Tregu i reklamave është i përqëndruar kryesisht në Ultësirën Perëndimore, sidomos në Tiranë dhe më pak në Durrës. Ekzistojnë edhe disa biznese relativisht të fuqishme të stabilizuar në zonën e Gjirokastrës. Nuk është rastësi që në zonën e Tiranës dhe në Ultësirën Perëndimore ofron shërbim numri, shumica e operatorëve radio e televizive (75 % të të gjithë operatorëve radio dhe 71.6 % operatorëve televizivë përfshirë dhe operatorët kombëtarë). Në këtë treg, operatorët kombëtarë janë konkurrentët më të fuqishëm, por edhe më të lakuar, pasi pretendohet që mbulimi i territorit, dhe për pasojë, edhe efektiviteti i reklamave të trasmetuara prej tyre është më i madh. Këtë rregull e ka prishur TV Top Channel, i cili nëpërmjet instalimit të pajisjeve të paautorizuara po i konkurron me sukses operatorët kombëtarë. Në këtë konkurrencë, Top Channel përfiton edhe nga fakti se ai nuk paguan asnjë detyrim për mbulimin jashtë zonës së licensimit. Kompanitë e fuqishme shtetërore, por edhe private, si KESH, ALBTELECOM, AMC, VODAFONE, INSIG, përdorin si kriter vlerësimi për shpërndarjen e reklamave, mbulimin me sinjal të territorit dhe shikushmërinë e një stacioni. Kjo është dhe një nga arsyet kryesore të kërkesave e presioneve nga shumë operatorë për t'u shpallur operatorë kombëtarë.

Zhvillimi i pamjaftueshëm i ekonomisë shqiptare, me potencialin e kufizuar të reklamave që rrjedh prej tij, është faktori kryesor penges edhe për zhvillimin e një tregu të konsoliduar të reklamave.

Shpenzimet

Investimet për krijimin e një rrjeti cilësor trasmetimi radio apo televiziv, është i konsiderueshëm. Shumë nga operatorët vendorë, sidomos ata të cilët janë licencuar për katër prefektura, për shkak të kostove të larta të investimit dhe mirëmbajtjes, vazhdojnë të paraqiten me tregues të ulët të mbulimit të zonës së tyre të licencimit.

Në veprimtarinë radiotelevizive, përveç investimeve për ndërtimin e rrjetit e të studiove, investimi kryesor aplikohet në veprimtarinë prodhuese, që për karakteristikat dhe kërkesat e veçanta ka kosto të lartë.

Për shkak të kostove të larta, një numër shumë i kufizuar operatorësh radio e televizivë janë në gjendje të prodhojnë apo të blejnë programme artistike, filma, evenimente sportive, etj. Eshtë fakt që, me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 9124, datë 29.07.2003, për luftën kundër piraterisë u konstatua një varfërim i programeve të transmetuara, pikërisht për pamundësinë financiare të shumë operatorëve për të blerë programe apo filma térheqës.

Në kërkim të burimeve të reja të të ardhurave, shumë operatorë po i drejtohen metodave “pay per view”, shërbimeve me pagesë. Kjo shpjegon numrin e madh të kërkesave për licencë për operatorë kabllorë që u verifikua gjatë vitit 2004, sidomos pas futjes në fuqi të ligjit kundër piraterisë. Po kështu, kjo është një nga arsyet e futjes së shërbimeve të reja, si televizioni numerik tokësor dhe trasmetimet numerike satelitore.

Konkluzion

Kostot e larta të mirëmbajtjes dhe të prodhimit të programeve, të ardhurat e ulëta të siguruara nga tregu i pазhwilluar e i deformuar i reklamave, nuk jepin garanci për sigurimin e qëndrushmërisë ekonomike të shumicës së operatorëve radio e televizivë.

Të dhënat e sjella më sipër, evidençojnë edhe një herë faktin e përmendur edhe vitin e kaluar se, shumica e operatorëve radio e televizivë përdorin të ardhura nga veprimitari të tjera, që nuk kanë lidhje me veprimitarinë radio apo televizive. Kjo vazhdon të forcojë dyshimet tona se operatorët radio e televizivë financohen nga burime jashtë aktivitetit, për të cilët janë licensuar. Mundësia për financime të paligjshme dhe për përdorimin e mediave për perpunimin e opinionit në favor të grupeve të caktuara, mbetet e hapur.

Për të mbajtur nën kontroll këtë fenomen, KKRT ka planifikuar organizimin e një studimi të hollësishëm për monitorimin e reklamave, si burimi kryesor i të ardhurave për TV, të bazuar në teknikën analoge, rezultatet e të cilët do të shpallen brenda 6-mujorit të parë 2005.

Gjatë vitit 2004, Kontrolli i Lartë i Shtetit, pas ushtrimit të kontrollit mbi veprimitarinë ekonomiko-financiare të institucionit tonë, për periudhën 2002, 2003 dhe gjashtë-mujorin e parë të vitit 2004, konstatoi se nuk është kryer asnje shkelje e disiplinës finanaciare, gjë që tregon se fondet e vëna në dispozicion të institucionit tonë, janë përdorur me efektivitet.

Aneks 2

TE DHENA PER VEPRIMTARINE LICENSUESE DHE NDESHKUESE ME OPERATORET RADIOTELEVIZIVE

Departamenti Juridik dhe i Licencave, si një nga departamentet kyç të administratës së KKRT-së, detyrën dhe objektivin kryesor të punës së tij ka zgjidhjen e problemeve që ndeshen në fushën radiotelevizive, në mbështetje të plotë me paketën ligjore që rregullon këtë fushë.

Gjatë vitit 2004, është evidentuar forcimi i mëtejshëm i institucionit, afirmimi i rolit të tij në rregullimin e transmetimeve radio e televizive, vendosja e lidhjeve të qëndrueshme institucionale, të cilat kanë mbështetur veprimtarinë e KKRT-së.

Puna e Departamentit Juridik dhe të Licencave ka konsistuar në sjelljen sa më afër funksionimit ligjor të transmetuesve radiotelevizivë, gjë që vërehet në përkushtimin e tyre për të respektuar sa më mirë detyrimet e ligjit dhe kushtet e licencës.

Drejtimet kryesore të veprimtarisë së këtij Departamenti kanë qënë si më poshtë:

- Përgatitja e materialeve për çështje të ndryshme të rendit të ditës së mbledhjeve të KKRT-së, duke përfshirë këtu projektvendimet e shoqëruara me relacionet përkatëse, si dhe është dhënë asistenca juridike në rastet e këruara për interpretimin dhe trajtimin e problemeve të ndryshme.

Gjatë periudhës së vitit 2004 janë marrë 96 vendime, nga të cilat 85 janë propozuar nga Departamenti Juridik dhe i Licencave, ose në masën 88.5%.

Ndër vendimet më kryesore mund të përmenden ato për miratimin e rregulloreve "Për përdorimin e ambienteve të RTSH nga subjektet private radiotelevizive", "Për licencimin e operatorëve radiotelevizivë të transmetimeve me kabëll", një pjesë e madhe janë për dhënien e licencave, shqyrtimin e ankesave të ndryshme etj.

- Ndrekja e problemeve që lidhen me të drejtat e transmetimit. Mbështetur në ligjin nr. 9124, datë 29.07.2003 dhe rregulloren "Mbi depozitimin e dokumentacionit për të drejtën e transmetimit" të miratuar me Vendimin nr. 165, datë 29.03.2003 të KKRT-së, operatorët radiotelevizivë në mënyrë periodike kanë depozituar dhe vazhdojnë të depozitojnë dokumentacionin përkatës për programet e transmetuara.

Krahas verifikimit, analizës dhe kompjuterizimit të marrëveshjeve të depozituara, për problemet e ndeshura është realizuar dhe një praktikë e gjerë shkresore me subjektet radiotelevizivë.

Për programet e transmetuara pa kontratë shitjeje, shkëmbimi apo dhurimi nga operatorët radiotelevizivë, janë ndërmarrë sankzionet përkatëse konform të gjitha akteve ligjore në fuqi. Konkretisht, janë vendosur masa me paralajmërim ndaj 18 operatorëve televizivë, si dhe 20 masa ndëshkuese me gjobë (Pasqyra bashkëlidhur).

Paralajmërim është bërë ndaj subjekteve TV Adriatik, TV Real, Tirana TV, TV Shijak, TVSH, Vizion + dhe TV Kuçova, si dhe ndaj TV kabllore të licencuar Elbasat, Lissus, Butrinti, Star, Iliria, Lushnja, Peshkopi, Laç, Lezhë, Ani.

Vlen të theksohet, se që nga momenti i hyrjes në fuqi të ligjit nr. 9124 e deri në momentin e lindjes në vendin tonë të teknologjive të reja të transmetimit (DigitAlb dhe Sat +), zbatimi rigoroz i tij solli rezultate të prekshme në veprimtarinë e operatorëve rtv, pasi fenomeni "pirateri" për programet e transmetuara u arrit të shuhej pothuajse plotësisht.

Përjashtimor ka qenë rasti i TV Shijak, i ndëshkuar me të pesë gjobat e mundshme, ndaj të cilit u morën disa vendime, duke caktuar afate për depozitimin e dokumentacionit përkatës që lidhet me të drejtën e transmetimit. Me gjithë kalimin e afateve të caktuara, subjekti televiziv "Shijak", nuk paraqiti asnjë dokumentacion që vërteton se zotëron të drejtën e transmetimit të programeve, për të cilën është ballafaquar me sanksionet e vendosura nga KKRT dhe për të cilat pretendonte gojarisht se i zotëronte.

Duke u ndodhur përballë kësaj situate, KKRT, me gjithë dëshirën e mirë duke i ofruar të gjitha mundësitë, por duke mos gjetur mbështetje nga ana e operatorit "Shijak", u detyrua në mbledhjen e datës 22.12.2004, me Vendimin nr. 298, t'i heqë licencën këtij operatori. Shkak tjetër që çoi në marrjen e këtij vendimi ishte dhe mossħlyerja e detyrimeve financiare për vitin 2003 (këto detyrime u shlyen në datën 23.12.2004, pra një ditë pasi ishte marrë vendimi). Vendimi për heqjen e licencës ka hyrë në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare nr. 101, datë 28.12.2004.

Megjithëse ligji parashikon si hap pasardhës reduktimin deri në 50% të afatit të licencës, duke qenë se:

- televizioni "Shijak", nuk ndërpree për asnjë çast transmetimet e paligjshme, por në mënyrë të vazhdueshme ka transmetuar në mënyrë pirate filma artistikë, dokumentarë apo koncerte për të cilat nuk paraqiti asnjëherë dokumentacionin e duhur, si dhe
- në kushtet kur mbetej vetëm 1 vit nga mbarimi i afatit të licencës së subjektit TV Shijak, apo 20% e afatit, që sidoqoftë përbën më pak se 50% të afatit të licencës ($5 \text{ vjet} \times 50\% = 2.5 \text{ vjet}$),

automatikisht ky reduktim kaloi në heqjen e licencës.

Nga ndjekja në vazhdimësi e zbatimit të të drejtave të transmetimit, është evidentuar fakti i një mënyre të re të piratimit të programeve. Kjo formë piratimi konsiston në falsifikimin e kontratave të depozituara, duke shtuar në këto të fundit, gjatë momentit të përkthimit dhe noterizimit të tyre, programe për të cilat nuk gëzojnë të drejta transmetimi. I tillë është rasti i subjektit televiziv TV Koha. Nga komunikimi zyrtar me RAI Trade rezultoi që, për një pjesë të filmave të transmetuar, TV Kohës nuk i ishte dhënë e drejta e transmetimit nga subjekti licencues (RAI Trade). Këto janë shtuar në mënyrë të paligjshme nga subjekti TV Koha.

Të gjendur përpara kësaj rrethane, për kontratat për të cilat ekzistojnë dyshime mbi vërtetësinë e tyre, bazuar në nenin 13 të ligjit dhe në nenin 3 të rregullores "Mbi

depozitimin e dokumentacionit për të drejtën e transmetimit", kemi filluar të kërkojmë nga subjektet radiotelevizive edhe dokumentacionin mbi bazën e të cilit buron e drejta e shitjes, shkëmbimit apo dhurimit, si dhe lejes për transmetimin në territorin e Republikës së Shqipërisë e subjektit licencues, për programet të cilat janë objekt i kontratës. Konkrektisht, ky dokumentacion i është kërkuar subjekteve televizive TNSH dhe Top Channel.

Për mosdepozitimin e tyre brenda afateve të vendosura, është ndërmarrë sanksioni i paralajmërimi, duke i vënë në dijeni se në rast të mosdepozitimit të këtyre të dhënavë brenda afateve të përcaktuara, mbështetur në nenin 137/4, pika 2/dh, KKRT do të ndërmarrë sanksion me gjobë (kur nuk jepen të dhënat e kërkua).

Kjo praktikë është ndjekur edhe me TVA, për të saktësuar faktin se si e justifikon transmetimin e Kampionatit Italian të Futbollit në sistemin satelitor me pagesë, ndërkohë që në mbështetje të paragrafit 4 të kontratës të lidhur me Rai Trade S.P.A, TVA gëzon të drejtën e transmetimit të këtij kompeticioni "free" dhe në sistemin analog dhe kabllor.

Afatet e vendosura për depozitimin e këtyre të dhënavë kanë kaluar duke mos u respektuar nga ana e këtyre operatorëve.

Mbetet një problem i shtruar për zgjidhje, gjetja sa më e mbështetur e një mënyre veprimi të KKRT-së për shfaqjen e rasteve të tilla të ngjashme.

Vështirësi paraqet transmetimi me teknologji dixhitale nga ana e subjekteve të palicencuar nga KKRT (Digitalb dhe Sat +), që kanë sjellë një situatë jo të këndshme në veprimtarinë radotelevizive dhe njëkohësisht cënimin e parimit është konkurrencës së ndershme. Këtyre subjekteve, duke qenë të palicencuar, KKRT nuk mund t'u kërkojë dokumentacionin përkatës për programet e transmetuara.

- Disiplinimi i operatorëve radiotelevizivë nëpërmjet licencimit, i cili krahas sanksionimit të të drejtave, i ngarkon ata edhe me detyrime. Në funksion të këtij qëllimi, janë shqyrtuar në mënyrë periodike letrat e interesit të paraqitura në KKRT dhe është vendosur sipas rastit:
 - shpallja në mënyrë publike e konkurrimit të kandidaturave për zonat ku ekzistojnë mundësitet teknike;
 - kthimi i përgjigjes negative për zonat ku nuk ka patur mundësi teknike;

Për periudhën Janar-Dhjetor 2004 janë depozituar rreth 40 kërkesa për t'u licencuar si operatorë rtv në sistemin analog. Për këto kërkesa të depozituara, pas studimit të disponibilitetit të frekuencave nga Departamenti Teknik, është organizuar në mënyrë periodike konkurrimi i kandidaturave për t'u licencuar si operatorë rtv. Konkrektisht, janë organizuar 6 procese për konkurrim kandidaturash, për të cilat janë shpallur njoftimet për shtyp (për qytetet Elbasan, Tiranë, Fier, Vlorë, Ballsh, Korçë, Lezhë, Shkodër, Peshkopi, Berat, Himarë, Librazhd, Gjirokastër).

Kërkesat për licencë për shërbime televizive në qytetin e Tiranës dhe Durrësit kanë marrë përgjigje negative, mbështetur në Vendimin nr. 143, datë 30.05.2003 të KKRT-së, duke qenë se spektri i radiofrekuencave është mjaft i ngarkuar, dhe mundësia për kanale të lira, është e pamundur.

Nga një numër jo i vogël operatorësh televizivë janë depozituar letrat e interesit për transmetime dixhitale ("Digitalb" sh.p.k., TV Ballkan, TV Apollon, TV Trio Cable, TV Shijak, TV Vizion +).

Në përgjigjet e dhëna për këto kërkesa, është bërë e qartë se KKRT, në përputhje me trendet dhe objektivat botërore, është duke punuar për krijimin e kuadrit të plotë ligjor dhe planifikimin e transmetimeve dixhitale.

Këtyre subjekteve u është bërë e qartë se disa nga çështjet kryesore për të cilat po kërkohet dhe punohet për zgjidhje janë:

- Afati i mbylljes së transmetimeve analoge, që do të përcaktojë dhe kohën e bashkëjetesës së transmetimeve analoge me ato dixhitale dhe masat për mbrojtjen reciproke;
- sigurimin e barazisë dhe mosdiskriminimit të subjekteve në procesin e marrjes së licencave;
- hartimin e planit të frekuencave dixhitale, përcaktimin e konfiguracionit të numrit të rrjeteve vendore, rajonale e kombëtare, koordinimit me vendet fqinje;
- sigurimit të aksesit të barabartë në platformat dixhitale për të gjitha subjektet, etj.

Në funksion të sa më sipër, në funksionin e drejtimit të Komisionit të Ekspertëve, të ngritur me urdhër të posaçëm të Kryetarit të KKRT-së, janë marrë në shqyrtim kërkësat dhe dokumentet e aplikimit të paraqitura nga ana e subjekteve private për licence për transmetim programesh radio e televizive, si dhe janë përgatitur relacionet përkatëse. Procedurat për licencimin e operatorëve të rind janë zhvilluar në përputhje të plotë me ligjin dhe relacionet e përgatitura i janë paraqitur Këshillit, mbi bazën e të cilave është bërë dhe licencimi ose jo i subjekteve.

Gjatë vitit 2004 (deri në fund të muajit Nëntor) janë licencuar 34 subjekte, nga të cilat: 7 për transmetim TV vendor, 6 për transmetim radio FM vendore dhe 21 për transmetim TV kabllor, si më poshtë:

1. TV abc (Korçë)
2. TV Magic Channel (Korçë)
3. TV Dibra Vizion (Peshkopi)
4. TV Alpo (Gjirokastër)
5. TV Channel 7 (Gjirokastër)
6. TV Color (Ballsh)
7. TV Bulqiza (Bulqizë)
8. Radio Nacional A.H. (Tiranë)
9. Radio Star (Fier)
10. Radio Klea (Elbasan)
11. Radio Alfa (Elbasan)
12. Radio Sport (Tiranë)
13. Radio Lezha (Lezhë)
14. TV kabell Elba-Sat (Elbasan)

15. TV kabëll DCN (Tiranë)
16. TV kabëll Inkusat (Pogradec)
17. TV kabëll HB-CATV (Peshkopi)
18. TV Kabëll Star (Tiranë)
19. TV kabëll Egnatia (Elbasan)
20. TV kabëll Iliria (Berat)
21. TV kabëll Lissus (Lezhë)
22. TV kabëll Korça (Korçë)
23. TV kabëll ALTE (Durrës, Laç, Rrëshen)
24. TV kabëll DEVI (Gramsh)
25. TV kabëll AVN (Fier)
26. TV kabëll Lezha (Lezhë)
27. TV kabëll ANI (Çorovodë)
28. TV kabëll Përmeti (Përmet)
29. TV Kabëll Kuçova (Kuçovë)
30. TV kabëll Poliçani (Poliçan)
31. TV kabëll Mati (Mati)
32. TV kabëll Asparag (Rrogozhinë)
33. TV kabëll Bulqiza (Bulqizë)
34. TV kabëll Kukësi (Kukës)

Siç mund të vihet re, ka një rritje të theksuar interesit për transmetim radioteleviziv nëpërmjet sistemit shpërndarës kabllor. Ky fenomen, i lindur kryesisht pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 9124, datë 29.07.2003, "Për disa shtesa në ligjin nr. 8410, datë 30.09.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", ka ndjekur ne numrin më të madh të rasteve, precedentin e daljes në transmetim pa autorizimin, licencimin e KKRT-së.

Për këtë shkak është kryer inspektimi në të gjithë territorin e R.SH. nga Departamenti Juridik dhe i Licencave dhe ai Teknik, duke mbajtur për çdo subjekt kundërvajtës, një akt-inspektimi, mbi bazën e të cilit është vendosur sanksioni përkatës. Këta subjekte kishin lidhur kontrata me qytetarët dhe ofronin shërbim pa zotëruar garancinë e vazhdimit të shërbimit, pa miratuar sheshin e ndërtimit pranë organeve të pushtetit vendor, pa paguar asnje lloj detyrimi. Disa prej tyre kanë qenë të regjistruar në organet fiskale dhe dispononin NIPT-in, duke mos patur nevojë të paraqisnin licencën për ushtrimin e aktivitetit. Madje, këta subjekte reklamonin shërbimin që ofronin, duke shpërndarë në çdo familje hollësi për çmimet, llojet e shërbimeve dhe adresat e zyrave.

Paralelisht me vendosjen e sanksioneve janë përgatitur urdhrat për mbyllje të aktiviteteve të palicencuara. Këtu vlen të theksohet bashkëpunimi shumë i mirë dhe frytdhënës me Policinë Tatimore.

Gjithashtu, KKRT ka kërkuar zyrtarisht edhe aktivizimin e bashkive në rrethe, si dhe të Ministrisë së Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit, të cilat kanë dhënë kontributin e tyre për parandalimin dhe ndërprerjen e këtij fenomeni. Sanksionet janë shlyer në mënyrë të

menjëherëshme nga ana e subjekteve kundërvajtëse, pasi u është bërë e njojur se, vetëm pas shlyerjes së gjobës, do të kenë mundësinë të aplikojnë për marrje licence. Tashmë, situata është e stabilizuar, pasi këta subjekte janë licencuar dhe kanë filluar të konkurrojnë në treg në kushte plotësisht të barabarta me operatorët e tjera radiotelevizivë. Shqetësimi i vetëm për subjektet televizive kabllore mbetet transmetimi i programeve të tyre pa logo, element i cili paraqet problem, pasi identifikimi i atyre operatorëve që do të shkelin dispozitat detyruese të ligjit, lidhur me programet e transmetuara, do të jetë i vështirë.

- Jo i njëjtë fenomen ka ndodhur me operatorët rtv vendorë. Operatorët rtv vendorë të licencuar gjatë këtij viti, në përgjithësi kanë dalë në transmetim vetëm pasi kanë marrë licencat përkatëse nga ana e Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizonit. Ky fakt përbën një progres në disiplinimin e operatorëve dhe moslejimin e transmetimeve të paautorizuara.

Ndërkohë, dalja në transmetim pa licencë ka ndodhur për operatorët televizivë të licencuar, duke instaluar pajisje jashtë zonës së licencimit. Si të tillë mund të përmendim rastet e TV Apollon dhe TV News 24, të cilët, pas ballafaqimit me sanksionet dhe procedurat ligjore për të tilla raste, në zbatim të detyrimeve ligjore, i mbyllën këto pajisje.

Ndërkohë, i njëjtë fenomen është konstatuar teknikisht edhe nga TV Koha dhe për të janë ndërmarrë veprimet përkatëse.

- Disiplinimi i operatorëve radiotelevizivë kabllorë të licencuar. Në zbatim të Urdhërit nr. 31, datë 07.04.2004, të Kryetarit të KKRT-së "Për inspektimin e operatorëve privatë radiotelevizivë të transmetimeve me kabell" dhe në mbështetje të nenit 137/1 "Inspektimi i veprimtarisë së të licencuarit", gjatë muajit Prill 2004 është kryer inspektimi i të gjithë subjekteve rtv kabllore.

Gjatë këtij inspektimi, për secilin operator u mbajt një akt-inspektimi, duke pasqyruar nga njëra anë, detyrimet e tyre sipas ligjit dhe rregullores përkatëse dhe nga ana tjetër, përbushjen e këtyre detyrimeve. Ky inspektim evidentoj disa probleme që lidheshin me:

- pajisjen me leje nga ERT-ja për vënien në punë të rrjetit kabllor për transmetim radioteleviziv;
- depozitimin e dokumentacionit për të drejtën e transmetimit të programeve radiotelevizive;
- depozitimin e bilanceve vjetore.

Me Vendimin nr. 244, datë 21.05.2004, "Mbi disa masa ndaj operatorëve radiotelevizivë kabllorë të licencuar", Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizonit vendosi disa afate për depozitim e tyre pranë KKRT-së, duke parashikuar në pikën 3 të tij, ndërmarrjen e sanksioneve sipas ligjit deri në heqjen e licencës për mosrespektim të afateve. Këto afate nuk u respektuan nga një pjesë e operatorëve, për të cilët, me Vendimin nr. 244/1, datë 31.08.2004, KKRT vendosi ndëshkimin me gjobë në masën 2% të xhiros vjetore të të ardhurave, si vijon:

- a) Trio Cable Televizion në masën 172.800 lekë (mbi bazën e ankesës së subjektit, me Vendimin nr. 272, datë 30.09.2004, KKRT ka miratuar uljen e masës së gjobës në shumën 72.000 lekë) (shlyer së bashku me kamatë-vonesën);
- b) TV Butrinti në masën 48.000 lekë;
- c) TV Irla në masën 180.000 lekë (shlyer);
- d) TV Kombi në masën 48.000 lekë (shlyer);
- e) TV Lushnja në masën 72.000 lekë (shlyer);
- f) TV Multivision në masën 75.000 lekë (shlyer).

Pra, nga të gjashtë subjektet, vetëm dy prej tyre nuk kanë paguar gjobën. Për këto subjekte, KKRT po ndjek, në zbatim te ligjit, vjeljen nëpermjet bashkëpunimit me Policinë Tatimore.

Ndaj subjektit televiziv kabllor CNA të licencuar me Vendimin nr. 144, datë 27.06.2003 të KKRT-së, nuk është mbajtur akt-inspektimi, pasi nuk ka dalë ende në transmetim. Për këtë subjekt, administrata e KKRT-së ka ndjekur procedurat ligjore duke përgatitur projektvendimin dhe relacionin përkatës për heqjen e licencës. Me Vendimin nr. 300, datë 22.12.2004, KKRT ka vendosur paraprakisht heqjen e licencës, duke lënë muajin Janar 2005, si afat përmarrjen e vendimit përfundimtar.

- Inspektimi në vend i subjekteve dhe bashkëpunimi me Policinë Tatimore për ekzekutimin e sanksioneve të vendosura nga KKRT.

Ky bashkëpunim gjen mbështetje në nenin 137/5 të ligjit nr. 8410, datë 30.09.1998, të ndryshuar, sipas të cilit, për ekzekutimin e vendimeve të KKRT-së, lidhur me gjobat dhe sanksionet, ngarkohet Policia Tatimore.

Mbështetur në kërkësën për ndihmën përkatëse nga kjo e fundit, është bërë i mundur ekzekutimi i vendimeve:

- nr. 197, datë 14.11.2003, "Për miratimin e sanksionit të vendosur ndaj TV AVN",
- nr. 146, datë 27.06.2003, "Për miratimin e sanksionit të vendosur ndaj subjektit Radio Kristal",
- nr. 139, datë 30.04.2003, "Për miratimin e sanksionit të vendosur ndaj TV Ballkan"
- nr. 136, datë 30.04.2003, "Për miratimin e sanksionit të vendosur ndaj REAL TV", duke bllokuar në vlerën e sanksionit të vendosur, pajisjet përkatëse.

Këto veprime janë pasqyruar dhe në informacionet përkatese drejtuar Kryetarit të KKRT-së.

Pas kalimit të afatit një-mujor nga data e bllokimit, mbështetur në nenin 137/2 të ligjit, për pajisjet e bllokuara i janë dërguar Policisë Tatimore urdherat për sekuestrimin e tyre. Kjo mbetet një çështje e papërfunduar, deri në momentin që do të ketë një përgjigje nga ana e organit tatimor për sekuestrimin e pajisjeve dhe dhënien e tyre për shitje subjekteve të ngarkuara me ligj. Sipas dispozitës së mësipërme, pjesa e tyre ardhurave nga shitja, rregullohet në kontratën përkatëse mes KKRT-së dhe subjekteve të ngarkuara me ligj, kalon në buxhetin e shtetit.

- Në zbatim të Urdhërit nr. 95, datë 02.12.2003 "Mbi zbatimin e ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, detyimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë" është ngritur Inspektoriat i Ulët i Kontrollit të Deklarimit të Pasurive në KKRT, në përbërje të të cilit është një specialist i Departamentit Juridik dhe të Licencave. Ky Inspektoriat ndjek në mënyrë të vazhdueshme detyrat që lindin në zbatim të ligjit të mësipërm.
